



UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTHEAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË  
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА  
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY

## STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

“Analiza e performancës ekonomike dhe financiare të kompanive të rajonit të Tetovës”

KANDIDATI:  
Avije Saliu

MENTORI:  
Prof. Dr. Rufe Osmani

Tetovë 2020

## Abstrakt

Kriza ekonomike aktuale ka ngjallur shqetësimin e investitorëve të mëdhenj, të mesëm, të vegjël dhe nevoja e përcaktimit real të vlerës së njësive ekonomike është e domosdoshme. Në këtë punim është bërë një përpjekje për vlerësimin e njësive ekonomike në aspektin e performancës së tyre.

Zhvillimi real i subjekteve afariste paraqet një parakusht për një ekonomi të shëndoshë dhe me perspektivë zhvillimore. Pasqyrat financiare janë treguesi bazë i të dhënave financiare ekonomike të subjekteve afariste që mundëson vlerësimin e gjendjes ekonomike financiare të një subjekti afarist për një periudhë të caktuar kohore.

Analiza e pasqyrave financiare paraqet procesin më të rëndësishëm të procedimit të të dhënave kontabël drejt krijimit të informatave relevante në procesin e vendimmarrjeve të rëndësishme afariste .

Procesi i analizës financiare është dizajnuar për të ndihmuar ndërmarrësit, investitorët dhe huadhënësit që të kuptojnë të tashmen dhe të projektojnë të ardhmen me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të afarizmit të tyre.

Përlllogaritjet dhe analiza financiare e subjekteve është bërë duke u bazuar nga llogaritë vjetore të një mostre përfaqësuese të përzgjedhur nga subjektet afariste të regjionit të Tetovës, si dhe duke përdorur literaturë adekuate në sajë të të cilave do të bëjmë interpretimin e duhur të treguesve të fituar.

Objektivi bazë i këtij punimi është të mat performancën ekonomike dhe financiare të bizneseve të madhësive dhe të veprimtarive të ndryshme dhe të konstatojë korelacionin në mes të faktorëve kryesor që ndikojnë performancën e bizneseve të analizuara.

**Fjalët kyçe:** Analiza financiare, pasqyrat financiare, performanca e ndërmarrjeve, subjektet ekonomike etj.

## Abstract

Current economic crisis has aroused the concern of investors, large, medium or small and need to determine the real value of entities is imperative. In this paper an attempt has been made to evaluate the entities in terms of their performance.

The real development of business entities is a precondition for a healthy economy with a development perspective. Financial statements are the basic indicator of financial and economic data of business entities that enables the assessment of the financial economic situation of a business entity for a certain period of time.

Financial statement analysis represents the most important process of processing accounting data towards the creation of relevant information in the important business decision-making process. The financial analysis process is designed to help entrepreneurs, investors and lenders understand the present and project the future in order to grow and develop their business.

The financial calculations and analysis of the entities was made based on the annual accounts of a representative sample selected by the business entities of the Tetovo region, as well as using adequate literature thanks to which we will make the correct interpretation of the acquired traders. The basic objective of this paper is to measure the economic and financial performance of businesses of different sizes and activities and to find the correlation between the main factors that affect the performance of the analyzed businesses.

**Keywords:** Financial analysis, financial statements, performance of enterprises, economic entities, etc.

## **Abstrakt**

Tekovната ekonomska kriza predizvika zagrizenost kaj investitorite, golemi, sredni, mali, i potrebata za utvrduvanje na realnata vrednost na ekonomskite subjekti e imperativ. Vo ovoj trud e napraven obid da se ocenat subjektite vo odnos na nivnata izvedba.

Vistinskiot razvoj na delovnite subjekti e preduslov za zdrava ekonomija so razvojna perspektiva. Finansiskite izvestai se osnovniot pokazatel za finansiskite i ekonomskite podatoci na delovnite subjekti sto ovozmozua procenka na finansiskata ekonomska sostojba na delovniot subjekt za odreden vremenski period.

Analizata na finansiskite izvestai pretstavuva najvazen proces na obrabotka na smetkovodstveni podatoci kon sozdavanje relevantni informacii vo procesot na vazno delovno odlucuvanje.

Procesot na finansiska analiza e dizajniran da im pomogne na pretpriemacite, investitorite i zaemodavatelite da ja razberat segasnosta i da ja proektiraat idninata so cel da rastat i da go razvivaat svojot biznis.

Finansiskite presmetki i analiza na subjektite se napraveni vrz osnova na godisnite smetki na reprezentativen primerok izbran od delovnite subjekti od tetovski region, kako i so upotreba na soodvetna literatura blagodarenie na sto ke napravime pravilno tolkuvanje na steknatite trgovci.

Osnovnata cel na ovoj trud e da se izmerat ekonomskite i finansiskite performansi na delovnite subjekti od razlicna golemina i aktivnosti i da se najde korelacijata pomegju glavnite faktori koi vlijaat na performansite na analiziranite biznisi.

Klucni zborovi: Finansiska analiza, finansiski izvestai, rabotenje na pretprijatija, ekonomski subjekti itn.

# PASQYRA E PËRMBAJTJES

<b>ABSTRAKT .....</b>	<b>2</b>
<b>ABSTRACT .....</b>	<b>2</b>
<b>ABSTRAKT .....</b>	<b>3</b>
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>2</b>
1.1. LËNDA DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT .....	2
1.2. HIPOTEZAT .....	2
1.3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	3
1.4. RËNDEسيا E PUNIMIT .....	3
<b>2. TRAJTIMI TEORIK.....</b>	<b>4</b>
2.1. PËRKUFIZIMI DHE LLOJET E SUBJEKTEVE EKONOMIKE .....	4
2.2. LLOJET E SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË UE .....	4
2.3. KLASIFIKIMI I SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË RMV .....	5
<b>3. RAPORTET FINANCIARE .....</b>	<b>7</b>
3.1. PËRMBAJTJA DHE KARAKTERISTIKAT E PASQYRAVE FINANCIARE .....	7
3.2. SHFRYTËZUESIT E RAPORTEVE FINANCIARE .....	9
3.3. AKTIVITETET E BIZNESIT NË EKONOMINË E TREGUT.....	9
3.4. RAPORTET FINANCIARE TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË MAQEDONINË E VERIUT .....	12
3.5. BILANCI I GJENDJES.....	12
3.6. RAPORTI I TË ARDHURAVE .....	12
3.7. RAPORTI I KAPITALI AKSIONAR .....	13
3.8. RAPORTI I RRJEDHËS SË PARAVE .....	14
3.9. RYSHQYRTIMI I ANALIZËS SË RAPORTEVE FINANCIARE.....	14
3.10. BILLOQET NDËRTUESE TË ANALIZËS .....	14
3.11. ANALIZA KOMPARATIVE E RAPORTEVE FINANCIARE .....	14
3.12. ANALIZA E MADHËSISË SË PËRBASHKËT TË RAPORTEVE FINANCIARE .....	15
3.13. ANALIZA E PËRPJESTIMEVE TË RAPORTEVE FINANCIARE – .....	15
3.14. ANALIZA E OBJEKTIVAVE DHE RAPORTEVE FINANCIARE .....	15
<b>4. PËRCAKTIMI I GJENDJES EKONOMIKE FINANCIARE TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE TË RAJONIT TË TETOVËS.....</b>	<b>16</b>
4.1. TREGUESIT .....	17
4.2. TREGUESIT E LIKUIDITETIT.....	17
4.3. RAPORTET E PËRDORIMIT TË AKTIVEVE.....	18
4.4. RAPORTET E AFTËSIVE PAGUESE (SOLVENTITETI).....	20
4.5. TREGUESIT E RENTABILITETIT ROI .....	21
4.6. RAPORTET E TREGUT .....	22
4.7. PREZENTIMI I KOMPANIVE NË RAJONIN E TETOVËS DERI MË 31.12.2019 .....	24
4.8. ANALIZA E TRENDIT NË BAZË TË TË HYRAVE TË PËRGJITHSHME PËR PERIUdhËN (2015-2019) .....	27
4.9. ANALIZA E TRENDIT TË SHPENZIMEVE TË PËRGJITHSHME PËR PERIUdhËN (2015-2019).....	30
4.10. ANALIZA E TRENDIT NË BAZË TË NUMRIT TË TË PUNUARVE PËR PERIUdhËN (2015-2019).....	32
4.11. ANALIZA E TRENDIT NË BAZË TË QARKULLIMIT VJETOR –FITIM/HUMBJE PËR PERIUdhËN (2015-2019)..	39
4.12. MESATARJA E TREGUESVE FINANCIAR PER PERIUdhËN (2015-2019) .....	44

<b>5. NDIKIMI I COVID-19 NË PERFORMANCËN E NDËRMARRJEVE TË ANALIZUARA DHE KRAHASIMI I REZULTATEVE ME VITIN 2019.....</b>	<b>46</b>
5.1. KUSHTET PËR MARRJEN E SUBVENCIONEVE. ....	47
5.2. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME .....	52
5.3. KONKLuzionET .....	52
5.4. REKOMANDIMET .....	54

# 1. Hyrje

## 1.1. Lënda dhe qëllimi i hulumtimit

Lënda do të përfshijë analizën e një numri reprezentativ të kompanive të nivelit mikro, të vogël dhe të mesëm të rajonit të Tetovës. Në kuadër të kompanive të përzgjedhura është mbajtur llogari që kompanitë të jenë të veprimtarisë prodhuese, shërbyese dhe tregtare në funksion të reprezentimit më cilësor të strukturës së ekonomisë së rajonit të Tetovës. Si rast studimi do të meren (20-40) kompani për një periudhë prej së paku 5 vitesh (2015-2019) të aktivitetit ekonomik nga rajoni i Tetovës.

Mostra reprezentative krahas madhësisë së kompanive dhe llojit të veprimtarive mer parasysh edhe nivelin e të hyrave, shpenzimeve, fitimit, tatimit në fitim, pagave dhe treguesve tjerë reprezentativ që identifikohen me performancën ekonomike dhe financiare të kompanive.

Tranzicioni ekonomik dhe politikë në vendet e Ballkanit Perëndimor edhe pse është në dekadën e tretë nuk ariti të përmyll dhe të bën funksional sistemet ekonomike dhe politike të këtyre vendeve ku bën pjesë edhe Maqedonia e Veriut.

Në kuadër të këtyre vendeve edhe në Maqedoninë e Veriut ky proces ka njohur shumë ndryshime sistemore dhe konjunkturale edhe në lëmin e investimeve, pagave dhe të profitit i shoqëruar me ndryshime permanente që ka pasur ndikim të drejtëpërdrejtë në performancën e kompanive dhe në raportimin financiar në harmoni me SNK dhe SLK që janë në fuqi në Maqedoninë e Veriut.

Tranzicioni ekonomik i njohur si proces i transformimit të sistemit ekonomik socialist në sistemin kapitalist dhe i shoqëruar me fenomenin e liberalizimit të çmimeve dhe të tregtisë së jashtme, stabilizimit të politikës monetare dhe fiskale dhe reformave strukturore kryesisht realizoi dy objektivat e para ndërsa rezultatet në objektivin e tretë janë në proces dhe me rezultate mjaft diskutabile (Rufi Osmani 2015).

Marrëdhënia ndërmjet të hyrave, shpenzimeve, fitimit dhe investimeve janë marrëdhënie të rëndësishme esenciale për funksionimin, stabilizimin dhe zhvillimin e çdo biznesi dhe në ato suaza edhe në rastin e bizneseve të rajonit të Tetovës.

Përderisa rritjet e të hyrave varen në masë të konsiderueshme nga pozicioni i kompanisë në treg, niveli i investimeve të reja dhe performancës teknologjike të kompanive prodhuese në rastin e shpenzimeve krahas shpenzimeve variable që janë nusprodukt i strukturës së asortimanit të prodhimit dhe teknologjisë që aplikon kompania në rastin e shpenzimeve fikse, një rol të konsiderueshem kanë edhe politikat e pagave dhe politika fiskale e përcaktuar nga qeveria e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë drejtim në pesë vitet e analizës (2015-2019) kemi politika mjaft konjunkturale të cilat në masë të konsiderueshme kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve të pagave dhe shpenzimeve të tjera të cilat tatimohen me tatim personal dhe tatim në fitim si pasojë e ndryshimeve të vazhdueshme të ligjit për tatim personal dhe tatim në fitim.

Objekti i bazë i këtij punimi është të mat performancën ekonomike dhe financiare të bizneseve të madhësive dhe të veprimtarive të ndryshme dhe të konstatojë korelacionin në mes të faktorëve kryesorë që ndikojnë në performancën e bizneseve të analizuar.

## 1.2. Hipotezat

Në bazë të qëllimeve të hulumtimit, në këtë punim do të shtjellohen hipotezat e mëposhtme:

**H1- Në kompanitë e mesme të veprimtarive prodhuese dhe shërbyese në rajonin e Tetovës ka korrelacion pozitiv në mes të trendit të të hyrave, shpenzimeve dhe fitimit në periudhën e analizuar.**

**H2- Në kompanitë mikro dhe të vogla në rajonin e Tetovës si rezultat i trendit rritës më të lartë të shpenzimeve mbi të hyrat ka efektuar ulje të performancës ekonomike dhe financiare në periudhën e analizuar.**

**H3- Performanca ekonomike dhe financiare e kompanive të analizuar (mikro dhe të vogla) duhet të miret me rezervë sepse shumica e kompanive krahas aktivitetit formal ushtrojnë paralelisht edhe aktivitet informal që nuk është pjesë integrale e pasqyrave financiare.**

### **1.3. Metodologjia e hulumtimit**

Në këtë punim magjistrature do të përdor të dhënat të cilat do të përpunohen nga bilancet e 20-40 firmave konkrete në rajonin e Tetovës dhe të dhëna të tjera nga Enti i Statistikave, Odat ekonomike dhe institucione të tjera cilat do të pasqyrojnë fenomenet ekonomike dhe financiare në Maqedoninë e Veriut.

Të dhënat e mbledhura nga 20-40 biznese, të sistemuara dhe të përpunuara do të përdoren edhe në metodë statistikore/sasiore për tu analizuar trende të ndryshme të fitimit apo humbjes së firmave edhe shpenzimeve të ndryshme të firmave.

#### **Metodat e përgjithshme shkencore:**

- Metoda e analizës, si pjesë e hulumtimit që do të bazohet në pasqyrat financiare, dokumentacionet tjera financiare dhe menaxheriale që do të shfrytëzohen nga arkivat e shoqërive të cilat do të janë objekt studimi.
- Metoda statistikore, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafikone me të dhëna për gjendjen aktuale dhe gjendjen në 5 vitet e fundit të kompanive.
- Metoda komparative (krahasuese), do të prezantohen rezultatet e arritura para tatimit dhe do të krahasohen me rezultatet e arritura pas tatimit duke vendosur në pah performancën e kompanive.

#### **Metoda të veçanta shkencore:**

- Metoda e analizës strukturore dhe dinamike
- Metoda analitike dhe sintetike
- Metoda kualitative dhe kuantitative
- Metoda fundamentale dhe empirike për studim.

### **1.4. Rëndësia e punimit**

Ky punim synon të mat performancën ekonomike-financiare të një numri të përzgjedhur të kompanive që janë mostër reprezentative e ambientit biznesor në rajonin e Tetovës. Trajtimi profesional dhe i thelluar i kësaj çështje është ende në fazat nismëtare në vendin tonë dhe nuk

ka hulumtime serioze as nga qarqet shkencore, qarqet biznesore dhe qeveritare përkundër faktit që performanca ekonomike dhe financiare e bizneseve është objektivi kryesor i politikave ekonomike në vend.

Rëndësia e punimit kryesisht lidhjet me gjetjet që do të arrihen, në kuadër të të cilave do të synohet të konstatohet e vërteta e performancës ekonomike të bizneseve të analizuar përkundër faktit se raportet financiare të 20-40 kompanive që do analizohen pjesërisht pasqyrojnë aktivitetin real të bizneseve dhe në ato suaza edhe performancën e vërtetë ekonomike-financiare të kompanive të rajonit të Tetovës.

Do të sigurohen informacione nga disa byro të kontabilitetit të Tetovës bazuar në raportet financiare vjetore të kompanive dhe nga të dhënat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperendimore dhe Entit të Statistikave të Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet edhe një anketë me menaxherët e kompanive të realizuara.

Informacioni kontabël vlerësohet prej qeverisë, biznesit dhe sindikatave si përfaqësues të punëtorëve si një nga elementet më të rëndësishëm për të matur performancën ekonomike dhe financiare përkundër faktit se këto raporte janë të ndikuara nga informaliteti i konsiderueshem.

## **2. Trajtimi teorik**

### **2.1. Përkufizimi dhe llojet e subjekteve ekonomike**

Biznesi është një aktivitet ekonomik. Aktiviteti i biznesit përfshin shërbimet, prodhimin, prodhimin e mallrave, aktivitetet e shpërndarjes, çdo gjë që dikush mund të prodhojë ose të shesë me qëllim që të ketë fitim.

Subjekti ekonomik gjithashtu mund të përkufizohet si një organizatë tregtare në të cilën elementet e prodhimit janë të harmonizuara në cilësore, sasiore dhe të përkohshme që kryejnë funksione të caktuara në procesin e riprodhimit social. Kompania prodhon produkte dhe shërbime për nevojat e tregut, duke përdorur burime të caktuara dhe duke ndërmarrë rreziqe për qëllime fitimi dhe qëllime të tjera ekonomike dhe sociale.<sup>1</sup>

### **2.2. Llojet e subjekteve ekonomike në UE**

Në çdo ekonomi dinamike duke pasur parasysh ndryshimet në kushtet e menaxhimit dhe qeverisjes së rregullave të tregut, parakusht themelor për sukses është funksionimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ato bëhen dominues sekondar, por në asnjë rast nuk duhet lënë pas dore rolin e kompanive të mëdha për zhvillimin ekonomik, sepse ato ende kanë efikasitet dhe produktivitet të madh dhe një ofertë të madhe për pushtimin e tregjeve botërore.

Ka shumë arsye për caktimin e madhësisë së subjekteve si p.sh nevoja e monitorimit statistikor, rregulloret të kontabilitetit, rregulloret tatimore etj. Duke pasë parasysh faktin se subjektet janë një grup heterogjen, është e vështirë të përcaktohet një kriter i vetëm apo një kombinim kriteresh, që do të japin një përgjigje definitive dhe unike. Në mënyrë tipike, gjatë përcaktimit të madhësisë së subjektit nisët nga qasja sasiore dhe cilësore.

Si kritere sasiore numërohen: pjesëmarrja e subjektit në treg, shkalla e përqendrimit, madhësia e shitjeve, madhësia e fitimit, numri i të punësuarve etj. Por ndonjëherë këto kritere ndryshojnë në vende të ndryshme, në varësi të legjislacionit.

Përkufizimi evropian për subjektet e vogla dhe të mesme është:<sup>2</sup> Kategoria e subjekteve

---

<sup>1</sup> Beaver Graham, Jennings Peter (2000), "Editorial overview: small business, entrepreneurship and enterprise development", Strategic Change, Vol. 9, Southampton, UK.

<sup>2</sup> Komisioni Evropian, <https://ec.europa.eu>



mikro, të vogla dhe të mesme është e krijuar nga subjekte që kanë më pak se 250 të punësuar dhe kanë qarkullim vjetor që nuk e kalon vlerën 50 milion Euro, ose bilanci i gjendjes nuk e kalon vlerën 43 milion Euro.

Tabela nr. 1 Klasifikimi i subjekteve ekonomike në UE

Kategoria e subjekteve	Numri i të punësuarve	Qarkullimi i mjeteve	Bilanci i gjendjes
Të mesme	< 250	≤ 50 milion €	≤ 43 milion €
Të vogla	< 50	≤ 10 milion €	≤ 10 milion €
Mikro	< 10	≤ 2 milion €	≤ 2 milion €

Burimi: [http://ec.europa.eu/The definition of SMEs according to the European Commission recommendation 2003/361/EC](http://ec.europa.eu/The%20definition%20of%20SMEs%20according%20to%20the%20European%20Commission%20recommendation%202003/361/EC)

Për shkak të të faktit që subjektet e vogla dhe të mesme veprojnë në treg të vetëm, pa kufij të brendshëm, inicohet një përkufizim i vetëm për efikasitet dhe qëndueshmëri të tyre.

Në këtë drejtim Komisioni Evropian ka dhënë një përkufizim për subjektet e vogla dhe të mesme dhe në bazë të modifikimit të tij të fundit merren parasysh këto kritere: numri i të punësuarve, fitimi vjetor dhe vlera vjetore e totalit të aktiveve.<sup>3</sup>

Përkufizimi është instrument i rëndësishëm për zbatimin e masave efektive dhe të këtë arsye Komisioni Evropian në marrëveshje me Bankën Evropiane të Investimeve dhe Fondin Evropian të Investimeve, bëjnë thirrje për implementimin më të gjërë të tij posaçërisht në shtetet e UE.

### 2.3. Klasifikimi i subjekteve ekonomike në RMV

Në vitin 2004 me ndryshimin e ligjit për subjektet ekonomike, Maqedonia e Veriut pranoi metodologjinë e Komisionit Evropian për klasifikim e subjekteve sipas madhësisë. Në bazë të kësaj metodologjie sipas tre kritereve (numri i të punësuarve, madhësia e qarkullimit dhe gjithsej vlera e aseteve operative), subjektet klasifikohen në mikro, të vogla të mesme dhe të mëdha.

Kriteri i parë (numri i të punësuarve) zbatohet edhe në Maqedoninë e Veriut, (Mikro deri në 10 të punësuar, të vogla deri në 50 të punësuar të mesme deri në 250 të punësuar dhe të mëdha mbi 250 të punësuar) ndërsa dy kriteret tjera janë të zvogëluara në përputhje ekonominë e Maqedonisë së Veriut (p.sh subjekte të vogla janë ato me qarkullim vjetor deri në 2.000.000 Euro në dallim me vendet në EU ku kjo vlerë është 10.000.000 Euro).

Klasifikimi i subjekteve në RMV sipas madhësisë së tyre, bëhet në përputhje me kufizimin e ndryshuar të Komisionit Evropian nga muaj maj i vitit 2003 kështu që merrem parasysh këto kritere: numri i të punësuarve, qarkullimi i mjeteve ose bilanci i gjendjes.

Në bazë të nenit 470 të ligjit të SHT (Shoqëri Tregtare), (Gazeta Zyrtare e RMV-SË )Nr. 84/05 dhe 25/07 nga janari i vitit 2006 subjektet ekonomike do të klasifikohen sipas këtyre kritereve:

**Mikro tregtar** - llogaritet ai tregtar i cili në dy vitet e fundit të njëpasnjëshme, apo në vitin e parë te aktivitetit i plotëson këto dy kritere:

- Mesatarja e numrit të të punësuarve në bazë të orëve të angazhuara duhet të jetë deri në **10 punëtorë**.

<sup>3</sup> Risteska Aneta, (2013) Doktoratura disertacija, vlijanie na malite i srednite pretprijatija vz ekonomskiot razvoj, so poseben osvrt na RM, Prilep

- Bruto të hyrat e përgjithshme të realizuara nga ana e tregtarit nuk i tejkalonjë **50.000 Euro** në kundër vlerë në denarë.

**Tregtar i vogël** – llogaritet ai tregtar, i cili në dy vite të njëpasnjëshme apo në vitin e parë të aktivitetit, plotëson minimum dy kriteriumet e mëposhtme: <sup>4</sup>

- Mesatarja e numrit të të punësuarve në bazë të orëve të angazhuara duhet të jetë deri në **50 punëtorë**.

- Të hyrat vjetore të realizuara nga ana e tregtarit duhen të jenë më pak se **2.000.000 Euro** në kundërvlerë në denarë, apo qarkullimi vjetorë të jetë më i vogël se **2.000.000 Euro** në kundërvlerë në denarë.

- Vlera mesatare e të gjitha mjeteve (nga fillimi e deri në fund të vitit përlogaritar në aktiv) duhet të jetë më e vogël se **2.000.000 Euro**,

**Tregtar i mesëm** - llogaritet ai tregtar i cili në dy vite të fundit të njëpasnjëshme, apo në vitin e parë të aktivitetit i plotëson të paktën tre nga kriteriumet e më poshtme:

- Mesatarja e numrit të të punësuarve në bazë të orëve të angazhuara duhet të jetë deri në **250 punëtorë**.

- Të hyrat vjetore të realizuara nga ana e tregtarit duhet të jetë më pak se **10.000.000 Euro** në kundërvlerë në denarë, apo qarkullimi vjetorë të jetë më i vogël se **10.000.000 Euro** në kundërvlerë në denarë.

- Vlera mesatare e të gjitha mjeteve (nga fillimi e deri në fund të vitit përlogaritar në aktiv) duhet të jetë më e vogël se **10.000.000 euro** në kundërvlerë në denarë.

**Makro tregtar** - Të gjitha shoqëritë tregtare që tejkalonjë kriteriumet e tregtarit të mesëm në RMV do të konsiderohen në kategorinë **tregtar i lartë**.

*Tabela. 2 Kategoritë e subjekteve ekonomike në RMV <sup>5</sup>*

Kategoria e subjekteve	Numri i të punësuarve	Qarkullimi i mjeteve në €
Mikro subjekte	1-9	<50. 000,00
Subjekte të vogla	10-50	≤ 2.000.000,00
Subjekte të mesme	51-249	≤ 10.000.000,00
Subjekte të mëdha	250>	>10.000.000,00

<sup>4</sup> R.Osmani, Kontabiliteti Financiar, Dispense e autorizuar, UEJL, 2018, Tetovë

<sup>5</sup> <http://ec.europa.eu>

## Klasifikimi i kompanive ne Maqedoni Në bazë të nenit 470 të ligjit të SHT dallohen këto forma:

Grafiku nr. 1 Klasifikimi i subjekteve ekonomike në RMV<sup>6</sup>



### 3. Raportet Financiare

#### 3.1. Përmbajtja dhe karakteristikat e pasqyrave financiare

Menaxhmenti mban përgjegjësinë kryesore për pasqyrat financiare të subjektit afarist.

Raportet financiare tregojnë realitetin ekonomik për punën e subjektit ekonomik dhe ato janë një mjet i dobishëm për menaxhimin dhe përdoruesit e tjerë dhe një bazë cilësore për vendimmarrje<sup>7</sup>.

Duke lexuar ashtu siç duhet pasqyrat financiare, prej tyre mund të kuptohet forca financiare e subjektit ekonomik, mënyra e financimit të aktiviteteve, niveli i borxhit, struktura e kapitalit dhe rezultati i arritur financiar.

Për të marrë vendime për investim apo kreditim, aksionerët dhe kreditorët do të mbështeten në perspektivat financiare të së ardhmes.

Bordi i drejtorëve si reprezentues i aksionerëve, shfrytëzojnë informacionet financiare për mbikëqyrje në vendimet menaxheriale, ndërsa puntorët dhe unionet e tyre për të bërë negociata në lidhje me punën. Nga ana tjetër, furnizuesit i shfrytëzojnë raportet financiare për të krijuar kushtet e furnizimit, ndërsa konsumatorët për të vendosur se si do të zhvillohen relacionet ofertë-kërkesë.

Pasqyrat financiare përgatiten një herë në vit. Subjektet mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha obligohen që gjer me datë 28/29- shkurt të vitit rrjedhës të dorëzojnë llogarinë vjetore për vitin e kaluar. Pasqyrat financiare përmbajnë këto elemente:

<sup>6</sup> R.Osmani, Kontabiliteti Financiar,(Standartet lokale të kontabilitetit) Ligjerata të autorizuar 2018

<sup>7</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë.

1. Bilancin e suksesit (raporti i fitimit ose humbjes – me raporte plotësuese për evidencë shtetërore).
2. Bilancin e gjendjes (raporti i gjendjes financiare).
3. Formulari – shpërndarja e të hyrave të realizuara sipas veprimtarisë (SDP)
4. Formulari i DE – raporti i të dhënave të veçanta për evidencën shtetërore.
5. Raporti i shënimeve plotësuese.
6. Bilanci tatimor i shpenzimeve të papranuara dhe i të hyrave më pak të prezantuara – formulari DB.
7. Bilanci tatimor i të hyrave të përgjithshme-formulari DB- VP. <sup>8</sup>

Tregtari individual si formë më e thjeshtë e organizimit të afarizmit në RMV obligohet që gjer me 15 mars të vitit vijues të dorëzojnë llogarinë vjetore për vitin e kaluar edhe atë:

1. Bilanci i të hyrave dhe të dalurave
2. Bilanci vjetor tatimor për tatim personal në të ardhurat PDD- DB.

Të gjitha format e shoqërive tregtare në RMV në datat e lartpërmendura janë obligues ndaj Ministrisë së Financave – Drejtorisë së të hyrave publike ti përcjellin vetëm bilancet tatimore ndërsa raportet tjera i përcjellin tek Regjistri Qendror i RMV-së.

Menaxhmenti i subjektit ekonomik për të krijuar të dhëna financiare me cilësi të lartë duhet t'i lejojë punëtorët financiar të përdorin zgjedhje të sofistikuara për përpunimin e të dhënave që do të jenë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe rregulloret vendore. Ky përpunim i të dhënave mundëson sigurinë e tyre dhe prezentimin e duhur.

Pasqyrat financiare ofrojnë informacion mbi pozicionin financiar, rezultatet dhe flukset e mjeteve monetare të subjektit ekonomik që janë të dobishme për një numër të madh të përdoruesve gjatë marrjes së vendimeve të biznesit. Pasqyrat financiare përshkruajnë rezultatet e menaxhimit të menaxhmentit ose përgjegjësinë e menaxhmentit ndaj burimeve që u janë besuar atyre.

Raportimi financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Prej 1 janar të v. 2012, ka filluar zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për subjektet ekonomike të vogla dhe të mesme. Zbatimi i SNRF për NVM rezulton me pasqyra financiare që sigurojnë një paraqitje objektive dhe reale të pozicionit financiar, të rezultateve financiare dhe të flukseve të mjeteve monetare të subjekteve ekonomike. Që objektivi i të dhënave që tregohen të jetë më i madh, është e nevojshme paraqitja më reale efektive të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret për njohjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Burimi bazë i të dhënave nga të cilat mund të krijohet analizë efektive financiare janë:

Pasqyrat financiare (Bilancet) e subjektit ekonomik, shënimet si dhe diskutimet me menaxherët. Në funksion të krahasimit me kompanitë konkurrese, analisti financiar përdor të dhënat përkatëse të krahasueshme nga kompanitë tjera dhe statistikën kombëtare. Për fat të keq një informacion i tillë në nivelin e ekonomisë kombëtare nuk është në dispozicion në vendin tonë.

---

<sup>8</sup> R.Osmani, Kontabiliteti Financiar,(Standartet lokale të kontabilitetit) Ligjerata të autorizuara 2018

Zyra shtetërore e statistikave ose regjistri Qendror i Llogarive vjetore duhet të krijoj një bazë të dhënash kombëtare të treguesve financiar, sipas degëve (industrive) rajoneve etj, por edhe në nivel shtetëror. Krahasimi është i rëndësishëm për të kuptuar vendin e biznesit – në aspektin e konkurrencës, të së kaluarës, brenda industrisë dhe shtetit.

### 3.2. Shfrytëzuesit e Raporteve Financiare

Pasqyrat financiare duhen të përgatiten në përputhje me legjislacionin kombëtar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standartet Kombëtare të Auditimit, duke garantuar kështu saktësinë dhe vërtetësinë e tyre. Konfirmimi i saktësisë dhe vërtetësisë së pasqyrave financiare ofrohet përmes auditimit të tyre.

Shfrytëzuesit e raporteve financiare janë klasifikuar në dy grupe:<sup>9</sup>

**Shfrytëzuesit e brendshëm** - kryesisht menaxherët e kompanisë, që janë të involvuar në sjelljen e vendimeve operative dhe strategjike në biznes. Raportet financiare interne janë posaçërisht të krijuara për informatat unike të nevojshme për sjellësit e vendimeve interne.

**Shfrytëzuesit e jashtëm** – që janë individual dhe jo drejtëpërdrejt të lidhur me veprimtarinë e kompanisë. Raportet financiare eksterne shqyrtojnë analizat e nevojshme për shfrytëzuesit ekstern, por shumë nga këto teknika analitike u hynë në përdorim edhe shfrytëzuesve intern.

Ekzistojnë disa grupacione të shfrytëzuesve ekstern të raporteve financiare:

- **Kreditorët** - si bankierët, mbajtësit e obligacioneve, etj të cilët shqyrtojnë raportet financiare që të vërtetojnë aftësinë e huamarrësit për të paguar interesin periodik si dhe shumën themelore në ditën e maturimit.
- **Investitorët në aksione** - duke përfshirë këtu aksionarët ekzistues, të cilëve informatat financiare u nevojiten që të vendosin se a duhet ti mbajnë aksionet apo t'i shesin ato edhe aksionarët potencial, të cilët duhet të zgjedhin mes alternativave investuese.
- **Analistët e bashkimeve dhe përvetësimeve të kompanive** - janë të interesuar në përcaktimin e vlerës ekonomike dhe potencialit financiar dhe operativ të kandidatëve për bashkim.
- **Auditorët** – shfrytëzojnë teknikat e analizës financiare duke determinuar sferat që kanë nevojë për vëmendje speciale gjatë ekzaminimit të raporteve financiare të klientit.
- **Bordi i drejtorëve** - në rolin e përfaqësuesve të aksionarëve, mbikqyrin veprimet menaxheriale.

**Agjencionet rregullatore** - shfrytëzojnë raportet financiare në detyrimet e funksioneve supervizore të tyre, duke përfshirë këtu edhe Komisionin e Sigurisë dhe Shkëmbimit i cili vazhdimisht përcjell raportet e publikuara financiare për të vërtetuar nëse janë në pajtim me ligjet federale të sigurisë.

**Punëtorët**- në vlerësimin real të pagave të tyre dhe kushteve punuese.

**Ndërmjetësit**- në ofrimin e këshillave investuese.

**Furnitorët**-në determinimin e kredibilitetit pagues të konsumatorëve.

**Konsumatorët**- në vlerësimin e qëndrueshmërisë së furnitorëve të tyre.

### 3.3. Aktivitetet e Biznesit në Ekonominë e Tregut

<sup>9</sup> R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuara,dispensa Tetovë 2018.

Bizneset ushtrojnë aktivitete të ndryshme me qëllim që të sigurojnë produkt që shitet dhe të arrijnë rikthim të kënaqshëm të investimeve. Raportet financiare dhe të dhënat tjera të ndërlydhura janë të dizajnuara që të na informojnë rreth katër aktiviteteve kryesore të kompanisë:

- Planifikues
- Financues
- Investues dhe
- Operativ

**1. Aktiviteti planifikues** – Kompanitë ekzistojnë që të arrijnë qëllimet dhe objektivat specifike, të cilat i përmban plani i biznesit që përshkruan qëllimet, strategjitë dhe taktikat e kompanisë. Duke u njoftuar me planet e biznesit në mënyrë të konsiderueshme e ndihmojmë analizën tonë rreth perspektivave të tashme dhe të ardhshme të kompanisë.

Aty mund të kërkojmë informacion për objektivat dhe taktikat, kërkesat e tregut, analizat e konkurrencës, strategjitë e shitjes (çmimi, promovimi, distribuimi) performancën menaxheriale si dhe proeksionet financiare.

**2. Aktiviteti i financimit** – Për zbatimin e planit të biznesit, kompanive u nevojitet financim. Për shkak të rëndësisë që ka ky aktivitet dhe potencial për të determinuar sukseset apo dështimet sipërmarrëse, kompanitë mundohen të sigurojnë dhe të menaxhojnë me burimet e tyre.

Dy burime kryesore të financimit në biznes janë: **Investitorët në aksione** (të njohur si akcionerë apo pronarë), dhe kreditorët (të njohur si huadhënsit).<sup>10</sup>

Investitorët në aksione përbëjnë pjesën dërmuese të financimit në biznes, dhe kanë për qëllim të rikthejnë në mënyrë të favorshme investimin e tyre.

**Rikthimi** - është një pjesë e fitimeve të kompanisë që i takojnë investitorëve në aksione dhe marin njërën nga dy format: Fitimi i shpërndarë apo fitimi i riinvestuar.

**Fitimi i shpërndarë** – nënkupton pagesën me para apo me aktive të tjera nga ana e kompanisë investitorit që ndryshe e quajmë **dividendë** dhe që shpesh paraqitet si përqindje: Dividenda/Fitimi. **Fitimi i riinvestuar** i referohet rritjes së vlerës së kompanisë përmes fitimit, dhe ndryshe quhet edhe rritje e barasvlerëshme, e cila poashtu paraqitet si përqindje . Rritja e barasvlerëshme /Vlera e investuar në kompani.

**3. Aktiviteti i investimit** – Aktiviteti i investimit me aktivet e siguruara nga financimi i kryen investimet që duhen bërë dhe me këtë zbaton planin e biznesit. Investimet përfshijnë tokën, ndërtesat, aktivet, të drejtat ligjore, (patenta, liçenca, e drejta e kopjimit) inventarin, kapitalin njerëzor (menaxherët, punëtorët), sistemin informativ si dhe të gjitha komponentat tjera të nevojshme për të operuar me kompaninë.

**4. Aktiviteti operativ** – Aktivitetet operative janë zbatuesit e planit të biznesit dhe së paku duhet të përfshijnë pesë komponentat themelore: kërkimin, blerjen, prodhimin, marketingun dhe punën. Një miks i përshtatshëm i këtyre komponentave të aktivitetit operativ varet nga lloji i biznesit, planet e tij dhe nga tregjet e inputeve (lëndët e para dhe gjysëmproduktet për prodhim).<sup>11</sup>

Këto aktivitete janë burimi kryesor i të të hyrave të kompanisë. Mënyra se si kompania sajton

<sup>10</sup> R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuara,dispensa Tetovë 2018.


<sup>11</sup> Matelievaska Margarita, Paceskoski Vlatko, (2011). Ekonomija na trgovski drushtva, Skopje.

planin e biznesit dhe strategjinë dhe si e bën kombinimin e aktiviteteve operative, determinon suksesin apo dështimin e biznesit.

#### Shtatë hapa të analizës financiare:<sup>12</sup>

- Qëllimi (përcaktohet se çfarë duhet të bëhet),
- Identifikimi (i të dhënave relevante nga kontabiliteti),
- Procesi (vendoset metoda e analizës për menaxhim),
- Llogaritja (krahasimi material i të dhënave),
- Krahasimi (krahasim i periudhave),
- Interpretimi (vlerësohet gjendja),
- Aksioni –veprimi.

#### Grafiku nr. 2 Mjedi i analizës së raportit financiar<sup>13</sup>



Bizneset ushtrojnë aktivitete të ndryshme që të sigurojnë produkte shitëse dhe te arrijnë fitim të knaqëshem të investimeve. Raportet financiare dhe të dhënat tjera të ndërlidhuara janë të dizanuara që të japin informacione rreth katër aktiviteteve kryesore të kompanisë që janë paraqitur në grafikon: Planifikues, Financues, Investues dhe Operativ.

<sup>12</sup> Charles T. Horning, GaryR. Filbrick, (2010) "Hyrje në Kontabilitetin Financiar", përkthimi i edicionit të nëntë, USA.

<sup>13</sup> R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuara,dispensa Tetovë 2018.

### 3.4. Raportet financiare të subjekteve ekonomike në Maqedoninë e Veriut

Aktivitetet e biznesit-planifikimi,financimi, investimi dhe operimi – janë sintetizuar në një pikturë kohezive të funksionimit të biznesit në ekonominë e tregut. **Raporti financiar** përgatitet një herë në vit në praktikë. Këto raporte i përfshijnë regjistrimet e bëra nga financimi dhe investimi, si dhe i përmbledhin të gjitha aktivitetet operative të bëra në periudhën e fundit. Në këtë mënyrë përgatiten katër raportet financiare primare: Bilanci i gjendjes, raporti i të hyrave, raporti i kapitalit aksionar dhe raporti kesh flou – it .

### 3.5. Bilanci i gjendjes

**Ekuacioni themelor i kontabilitetit** është baza e sistemit raportues financiar:

$$\boxed{\text{Aktiva} = \text{Detyrimet} + \text{Kapitali aksionarë}}$$

**Detyrimet paraqesin** detyrime të kompanisë të financuara nga kreditorët.<sup>14</sup>

**Kapitali aksionar** paraqet totalin nga:

1. Fondi i investuar apo i kontribuar nga aksionerët (kapitali i kontribuar)
2. Fitimet e akumuluar që nga themelimi i kompanisë si shtesë e distribuimit aksionar (fitimet e kthyera), të cilat nga pikëvështrimi i aksionarëve paraqesin kërkesë mbi aktivet e kompanisë.

Bilanci i gjendjes përmbledh pozitën financiare të kompanisë për kohën e caktuar. Shumicës së kompanive sipas praktikave të pranuar kontabiliste, u nevojitet të prezantojnë bilanc të klasifikuar të gjendjes. Në këtë bilanc aktiva dhe detyrimet janë të ndara në konto vijuese dhe jovijuese.

Aktivitet vijuese pritet që të konvertohen në para të gatshme apo të shfrytëzohen në operacione brenda një viti apo brenda një cikli operativ.

Detyrimet vijuese janë detyrime që kompania duhet t'i shlyejë në periudhën e njëjtë kohore. Dallimi ndërmjet aktiveve vijuese dhe detyrimeve vijuese është kapitali vijues. Bilanci i gjendjes klasifikohet sipas kategorive kryesore të aktiveve dhe kapitalit dhe llogaritë e mëtejshme grupohen në nën kategori, me qëllim që përdoruesit e pasqyrave financiare të kenë një pasqyrë më të qartë të pozitës financiare të subjektit ekonomik dhe t'i kushtoj vëmendje llogarive speciale. Bilanci i zgjedhjes jep informacion rreth aftësisë së subjektit ekonomik për të përmbushur nevojat dhe borxhet operacionale afatshkurta. Investitorët janë më së shumti të interesuar në perceptimin e subjektit ekonomik për të pasur vit financiar me fitim dhe për të paguar dividendë.

### 3.6. Raporti i të ardhurave

Raporti i të hyrave mat performancën financiare të kompanisë ndërmjet tatimeve të

<sup>14</sup> R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuara,dispensa Tetovë 2018.



bilancit të gjendjes, prandaj reflekton një periudhë të caktuar kohore. Ai regjistron të ardhurat, shpenzimet, fitimet dhe humbjet e kompanisë në një periudhë kohore. Të hyrat neto tregojnë zmadhimin apo zvogëlimin e pasurisë së kompanisë, para marrjes në konsiderim të dhënat dhe kontributeve të aksionarëve.

Në praktikë të hyrat neto përcaktohen duke e shfrytëzuar bazën e pastër kontabël. Me këtë metodë të ardhurat njihen kur kompania shet prodhimet apo shërbimet e saja, pa marrë parasysh pranimin e parave të gatshme, përkundër kësaj shpenzimet njihen atëherë kur regjistrohen të ardhurat, pa marrë parasysh pagesën e tyre me para të gatshme.

Bilanci i suksesit përmban informacione të rëndësishme që ndihmojnë investitorin gjatë marrjes së vendimit të tij të investimeve, si dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm. Nëse pasqyra e të ardhurave tregon një humbje, kjo do të thotë se bashkëpunorët do të jenë të kujdesshëm, sidomos në qoftë se subjekti kërkon kredi, prandaj është shumë rëndë, pothuajse e pa mundur t'u jepet kredi subjekteve të tilla.

Në fillim të çdo biznesi, subjekti ekonomik në shumicën e rasteve ka investime fillestare të cilat janë të larta e kanë për qëllim të ndihmojnë për të filluar me punë subjekti dhe si pasojë e kësaj në vitet e para të operimit të biznesit, subjekti paraqitet me humbje. Por edhe pse rezultojnë me humbje, nuk do të thotë që biznesi nuk është kosto-efektiv për periudhë afatmesme apo afatgjate. Por nëse pas viteve fillestare kur kemi investime subjekti ekonomik sipas rezultateve financiare ende po punon me humbje, duhet parashtruar pyetja nëse biznesi është koto –efektive dhe renatbil.<sup>15</sup>

### **3.7. Raporti i kapitali aksionar**

Raporti i kapitalit aksionar i përshkruan ndryshimet kontabël të ndodhura në kapitalin aksionar. Ky raport është i rëndësishëm në identifikimin e arsyeve për ndryshime të kërkesave aksionare për aktivet e kompanisë. Praktikën e pranuar e përshtojnë fitimet dhe humbjet e sigurta nga të hyrat neto, prandaj ato evidentohen në raportin e kapitalit aksionar.

Raport ky, që paraqet ndryshimet individuale të kapitalit të ndodhura për disa arsye, dhe atë: shitjes së aksioneve për akuizicion, si dhe përshkak të riinvestimit në të hyrat neto.

Raporti mbi ndryshimet në kapital (kapitali) përmban informacionin e mëposhtëm:<sup>16</sup>

- Të ardhurat e përgjithshme gjithëpërfshirëse për periudhën, duke treguar veçmas shumën e përgjithshme që u takojnë pronarëve të subjektit ekonomik dhe pjesëmarrjes së pakontrolluar (pronarëve të vegjël të kapitalit).

- Për çdo komponent të kapitalit, efektet e zbatimit retrospektiv të ndryshimeve në politikën kontabël ose rregullimi retrospektiv i shumave të njohura sipas SNK 8.

- Ndryshimet në kapitalin neto të subjektit ekonomik midis dy datave të bilancit të gjendjes pasqyrojnë një rritje ose rënie në aktivet neto ose pasuri gjatë periudhës së kontabilitetit, sipas parimeve specifike të matjes, të miratuara dhe të shpalosura në pasqyrat financiare.

Përveç ndryshimeve që rrjedhin nga transaksionet me aksionarët, ndryshimi i kapitalit të përgjithshëm përfaqëson fitimet dhe humbjet totale që rrjedhin nga aktivitetet e subjektit të biznesit gjatë periudhës kontabël.

<sup>15</sup> R.Osmani „Analiza e pasqyrave financiare, ligjerata e autorizuara, dispensa Tetovë 2018.

<sup>16</sup> Nikolovski Pece, (2003). Analiza i revezija na finansiskite izveshtai na pretprijatijata vo RM vo funkcija na ekonomska efikasnost" – Doktorska Disertacija, Ekonomski Fakultet – Prilep.

### 3.8. Raporti i rrjedhës së parave

Sipas kontabilitetit të përpiktë, të hyrat neto zakonisht nuk përputhen me cash flow-in, përveç në fund të jetës së kompanisë. Mu për këtë arsye dhe përshkak të rëndësisë që kanë të hyrat dhe të dalat e parave në kompani, është e nevojshme raportimi periodik i cash flow-it.

Ky raport financiar evidenton të hyrat dhe të dalat e kompanisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të saja financiare, investive dhe operative në një periudhë të caktuar kohore.

Pasqyra e rrjedhës së parasë shpjegon se nga rrjedhin paratë e subjektit ekonomik dhe ku është shpenzuar për një periudhë kohore. Mjetet monetare të njësisë ekonomike përfshijnë kesh-in në qarkullim, të holla në llogaritë e bankave dhe ekuivalentët e tyre.

Pasqyra e rrjedhës së parave lejon që investitorët dhe menaxherët të ndiejnë pulsën e qarkullimit të “gjakut” – në çdo kompani. Pikëpamjet në lidhje me mirëmbajtjen e nivelit të fondeve ndryshojnë. Disa menaxherë dhe investitorë preferojnë sigurinë duke mbajtur sasi të mëdha të parave të gatshme, ndërsa të tjerët minimizojnë praninë e parave të gatshme pasi ato sigurojnë vetëm fitime të vogla për subjektin ekonomik.

Tabela nr. 3 Raportet financiare që dërgohen ne Regjistrin Qendror të M.V

Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozicionit financiar në fund të periudhës)	Bilanci i suksesit (Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën)	Pasqyra e ndryshimeve në kapital	Raporti i rrjedhës së parasë	Shënime, të cilat mbulojnë një pasqyrë të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacione të tjera sqaruese dhe raporte / rishikime që pritet të lexohen me këto raporte
--	---	----------------------------------	------------------------------	---

Burimi:WWW.crm.org.mk

### 3.9. Rishqyrtimi i analizës së raporteve financiare

Gjatë analizimit të raporteve financiare, shfrytëzuesit kanë aktive të ndryshme prej të cilave zgjidhen ato që u përshtaten më së miri nevojave të tyre specifike.

### 3.10. Blloqet ndërtuese të analizës

Analiza financiare e motivuar në vetë përfshinë këto aspekte:<sup>17</sup>

- Likuiditetin afatshkurtër. Aftësia e kompanisë për t'i shlyer detyrimet afatshkurtra.
- Vijueshmëria e fondeve. Mundësia dhe dispozicioni i ardhshëm për kesh.
- Struktura kapitale dhe aftësia paguese afatgjate.
- Rikthimi i investimeve. Aftësia e kompanisë të ofron shpërblime financiare të mjaftueshme për t'i tërhequr dhe për t'i ruajtur furnizuesit e financimeve.
  - Aktivitetet utilizuese. Intesiteti i aktiveve në krijimin e të ardhurave për të arritur nivel të mjaftueshem të profitabilitetit.
  - Performanca operative. Suksesshmëria e kompanisë në maksimizimin e të ardhurave dhe në minimizimin e shpenzimeve të aktiviteteve operative afatgjate.

### 3.11. Analiza komparative e raporteve financiare

<sup>17</sup> R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuar,dispensa Tetovë 2018.

Shfrytëzuesit e raporteve financiare i ndërtojnë analizat komparative të raporteve financiare duke ndërtuar në mënyrë të njëpasnjëshme bilance të gjendjes, raporte të të hyrave apo raporte të cash flow –it, duke rishqyrtuar ndryshimet në kategoritë individuale, vit pas viti apo mbi baza shumëvjeçare.

Çështja më e rëndësishme e shqyrtuar nga analiza komparative e raporteve financiare është trendi (prirja).

Në praktikë janë të njohura dy lloje të teknikave të analizës komparative:

**1. Analiza e ndryshimeve vit pas viti** - kjo teknikë e analizës komparative shfrytëzohet për krahasimin e raporteve financiare gjatë periudhave të shkurtra kohore – dy deri tre vitesh, pasi që ka përparsi në prezantimin e ndryshimeve në vlera absolute të dollarit dhe në përqindje.

**2. Analiza e trendeve serike të numrave indekset** - kjo lloj teknike e analizës komparative është një procedur e shkëlqyer për të ndikuar në krahasimet e trendeve më afatgjate. Për të analizuar të dhëna me këtë teknikë, nevojitet që të caktohet një vit bazik për të gjithë çështjet, me numër-indeks të selektuar që zakonisht është 100.

### **3.12. Analiza e madhësisë së përbashkët të raporteve financiare**

Gjatë analizimit të bilancit të gjendjes, është e zakonshme të paraqiten aktivet totale, detyrimet dhe kapitali me vlerë 100%, ndërsa pjesët përbërëse të këtyre kategorive si përqindje e totalit përkatës.

Duke analizuar edhe raportin e të hyrave, të ardhurat neto janë të paraqitura me vlerë 100%, së bashku me pjesët tjera përbërse të raportit të të hyrave të paraqitura si përqindje e të ardhurave neto. Pasi që shuma e këtyre pjesëve individuale është 100, kjo teknikë e analizës është quajtur si madhësia e përbashkët e raporteve financiare, ose njihet edhe si analiza vertikale.

### **3.13. Analiza e përpjestimeve të raporteve financiare**

Raportet janë një ndër instrumentet më të njohura dhe më gjërësisht të përdorura nga analiza financiare. Proporcioni (raporti) paraqet funksion matematikor ndërmjet dy madhësive p. sh proporcioni në mes numrit 200 dhe 100 paraqet si 2:1, apo thjeshtë vetem 2. Përderisa llogaritja e tyre është një operacion aritmetik, interpretimi i tyre është shumë kompleks.


Për të qenë më kuptimplote, ato duhet që ti referohen ndonjë relacioni të rëndësishëm ekonomik p.sh ekziston një lidhje direkte dhe e rëndësishme ndërmjet çmimit shitës dhe kostove të tij.<sup>18</sup>

### **3.14. Analiza e objektivave dhe raporteve financiare**

Analiza e raporteve financiare varet nga objektivat e vëna nga shfrytëzuesit e analizës. Për ta zotëruar plotësisht analizën tonë, duhet që t'i kuptojmë tre pjesët integruese të kontabilitetit, dhe atë: funksionin e regjistrimit, sistemin e regjistrimit të dyfisht dhe klasifikimin.

Grafiku nr. 3 Analiza e objektivave dhe raportimit financiar

<sup>18</sup> R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuara,dispensa Tetovë 2018.



Objektivat e analizës së raporteve financiare varen nga perspektiva dhe nga sfidat që do ti përballojnë. Vendimmarrjet në biznes varen nga raportimi i këtyre raporteve financiare:

- I. Përdoruesit e informatave të analizës financiare.
- II. Informacionet kontabël,
- III. Principet kontabël,
- IV. Analiza plotësuese.

#### 4. Përcaktimi i gjendjes ekonomike financiare të subjekteve ekonomike të rajonit të Tetovës

**Racio analiza** – konsiderohet si bazë për marrjen e vendimeve racionale të biznesit. Qëllimi i analizës financiare është të përcaktojë sasinë dhe vlerësimin e marrdhënieve funksionale që ekzistojnë midis pozicioneve të bilancit në mënyrë që të sigurohen informacione të besueshme për pozicionin financiar dhe aktivitetet e subjekteve ekonomike.

Në të vërtetë kjo analizë shqyrton marrdhëniet midis pjesëve të lidhura të pasqyrave financiare, në mënyrë që të nxjerrë në pah dhe shpjegojë marrdhëniet kyçe që varen nga pozicioni financiar i tanishëm dhe i ardhshëm i subjektit ekonomik<sup>19</sup>. Racio analiza paraqet raport matematikor midis dy madhësive.

Racio analiza është produkt i pasqyrave të ndryshme financiare dhe rëndësia e tij perceptohet kryesisht në përmlledhjen e marrdhënieve dhe rezultateve kyçe që tregojnë performancën financiare të subjektit.<sup>20</sup>

Racio numrat (fjala Racio e ka prejardhjen nga anglishtja që do të thotë marrëdhënie) janë numra që përfaqsojnë një marrëdhënie midis dy pozicioneve të lidhura në mënyrë funksionale. Ato përdoren në analiza të pjesërishme financiare.

Përmes analizës së pasqyrave financiare, menaxhmenti financiar mund të identifikojë dobësitë e organizatës, me qëllim që ato ti korrigjojë. Po kështu, edhe kreditorët janë të interesuar të vlrësojnë gjendjen dhe sigurinë e huave të tyre.

<sup>19</sup> Matelievka Margarita, Paceskoski Vlatko, (2011). Ekonomija na trgovski drushtva, Skopje.

<sup>20</sup> Ivanis M., (2012) "Uvod u korporativne finansije i tehnike upravljanja korporativnim finansijama", Univerzitet Singidunum Beograd, Serbija

Analiza e pasqyrave financiare me anë të përlogaritjes së treguesve mund të jetë një mjet shumë i dobishëm për menaxhmentin për të verifikuar afarizmin vijues të subjektit dhe pozitën e tij në krahasim me konkurrencën.

Një analizë e kryqëzuar brenda grupit të subjekteve të njëjta, apo të ngjajshme, do të tregojë nëse një subjekt i caktuar ec më shpejt apo më ngadalë nga mesatarja e asaj fushe.

Në kuadër të treguesve financiar bëjnë pjesë:

1. Treguesit e likuiditetit
2. Treguesit e përdorimit të aktiveve,
3. Treguesit e aftësive paguese,
4. Treguesit e rentabilitetit ROI,
5. Treguesit e tregut.

#### 4.1. Treguesit

#### 4.2. Treguesit e likuiditetit

Likuiditeti është aftësia e subjektit ekonomik për të shlyer të gjitha detyrimet e tij aktuale (të përditshme) brenda afatit të parashikuar. Në qoftë se një subjekt është likuid, ai do të jetë në gjendje të shlyejë në kohë obligimet e tij.

Likuiditeti i subjektit ekonomik është një element i rëndësishëm i rezultateve të tij financiare, sepse ai varet jo vetëm nga marrdhëniet e mira të biznesit me kreditorët, por gjithashtu edhe nga mbijetesa e tij, sepse subjekti ekonomik që është jo likuid në një periudhë të caktuar kohe është një kandidat serioz për falemintim dhe likuidim.<sup>21</sup>

Analiza e likuiditetit shpesh kërkon një krahasim dinamik të aktiveve afatshkurta (sidomos të parasë së gatshme) me maturimin e detyrimeve të subjektit muaj për muaj ose ditë pas dite<sup>22</sup>. Likuiditeti i një subjekti ekonomik do të jetë më i madh nëse disponon më shumë fonde nga burimet e veta se nga burimet e huaja dhe nëse qoftë se ato janë më shumë të një natyre afatgjate sesa të një mënyre afatshkurte.

Aktivitetet e likuide përfshijnë një pjesë të kapitalit punues që mund të përdoren menjëherë ose në një periudhë relativisht të shkurtër për pagesën e detyrimeve afatshkurta. Ato përfshijnë të holla, kërkesa afatshkurta dhe plasmanet në letrat me vlerë afatshkurtra.

Llojet e mëposhtme të raporteve-likuiditete përdoren për analiza statistikore:

#### Raporti i likuiditetit rrjedhës

Treguesi i likuiditetit rrjedhës është treguesi më i përgjithshëm i likuiditetit të subjektit ekonomik, që tregon aftësinë e subjektit ekonomik për shlyerjen e detyrimeve afatshkurte (korente).

Detyrimet korente janë detyrime me maturim prej një viti dhe ato mund të shlyhen nga mjetet në dispozicion që do të mund të konvertohen në para në dorë për një periudhë një vjeçare. Raporti rrjedhës është raporti i mjeteve rrjedhëse ndaj detyrimeve rrjedhëse. Ai tregon se sa mirë janë mbuluar detyrimet me afat të shkurtër të cilat duhen të paguhen brenda vitit.

$$\text{Likuiditeti rrjedhës (korent)} = \frac{\text{Aktivet (mjetet) rrjedhëse}}{\text{Detyrimet rrjedhëse}}$$

<sup>21</sup> Sasho Arsov, (2008) "Finansiski Menaxhment", Skopje.

<sup>22</sup> Zeqiri Izet, (2004). "Menaxhimi Financiar", Tetovë.

Implikimi analitik: Sa më i lartë të jetë raporti korent, aq më shumë mundësi ka subjekti të paguaj detyrimet afatshkurtra.

Një raport korent më i vogël, do të thotë që kompania ka kapital qarkullues negativ dhe se është duke kaluar krizë likuiditeti.

Aktivet korente ose qarkulluese zakonisht përfshijnë zërat e arkës, bankës, inventarët, llogaritë e arkëtueshme dhe investimet afatshkurtra.

Detyrimet korente ose afatshkurtra përbëhen nga llogaritë e pagueshme, dëftesa të pranuar, hua bankare, tatime etj. Nëse detyrimet korente rriten më shpjetë se aktivet korente, atëherë raporti korent do të ulet dhe kjo do të thotë se ka probleme likuiditeti.

Ky tregues është një sinjal për mbrojtjen e kreditorëve afatshkurtër dhe prandaj është e dëshirueshme që subjekti ekonomik të rrisë shkallën e mbulimit të detyrimeve afatshkurtra dhe kështu kërkesat e tyre të jenë subjekt i një rreziku më të ulët të mos arkëtueshmërisë.<sup>23</sup>

### **Raporti i likuiditetit të përshpejtuar ose i Testi Acid**

Testi acid (raporti i shpejtë) – është një raport me më konservator se raporti korent pasi në llogaritje nuk përfshihet inventari ose aktive të tjera të cilat nuk janë shumë likuide .

Detyra kryesore e këtij treguesi është të plotësojë imazhin e dhënë nga treguesi i mëparshëm. Pra qëllimi i këtij treguesi është vlerësimi i mundësisë që subjekti ekonomik të paguajë detyrimet e tij afatshkurtra duke përdorur aktivet më likuide<sup>24</sup>.

Rrjedhimisht, sipas këtij raporti sasi të janë marrë dhe jo vetëm sasi të e vjetruara, por inventarët në përgjithsi, sepse ato nuk përbëjnë një burim likuid fondesh siç janë paratë e gatshme dhe kërkesat. Për shembull, nëse bisedohet për stoqe të materialeve, së pari ato duhet të harxhohen në procesin e prodhimit për të marrë një produkt të gatshëm dhe pastaj duhet të kalojë një kohë shtesë për të shitur stokun e produkteve të gatshme.

$$\text{Testi acid} = \frac{\text{Aktivet rrjedhëse} - \text{Inventarët (stoqet)}}{\text{Detyrimet afatshkurtra}}$$

Thelbi i këtij treguesi është se ajo duhet të arrijë në një minimum prej 1 ose më shumë, do me thënë detyrimet aktuale nuk duhet të jenë më të mëdha se asetet më likuide.

### **Raporti i likuiditetit monetar**

Ky tregues plotëson raportin rrjedhës të likuiditetit. Ai mat shumën e parave dhe ekuivalentëve të saj në dispozicion për të mbuluar detyrimet aktuale.

Ky lloj treguesi llogaritet duke e përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Raporti i likuiditetit monetar} = \frac{\text{Cash}}{\text{Detyrimet afatshkurtra}}$$

- Nëse treguesi është më i madh se 1, atëherë njësia ekonomike përkatëse likuidohet në ditën e matjes së likuiditetit.

- Nëse treguesi është i barabartë me 1, atëherë është kufiri minimal nën të cilin nuk duhet të ulet.

- Nëse treguesi është më i ulët se 1, atëherë paraja në dispozicion nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e duhura.

### **4.3. Raportet e përdorimit të aktiveve**

<sup>23</sup> Maxhova Violeta, (2010) Modeli za procenta na solventnost na bankarskite klienti, Skopje.

<sup>24</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

Grupi tjetër i raporteve, raportet e aktiveve (mjeteve totale), matin efektivitetin e menaxhimit të aktiveve nga shoqëria. Nëse një shoqëri ka shumë aktive, kostoja e kapitalit të saj do të jetë tepër e lartë dhe si rrjedhim fitimet e saj do të ulen.

Në anën tjetër nëse aktivet e saj janë tepër të ulëta, fitimet nga shitja do të ulen. Subjekti investon në kapitalin bazë dhe atë punues për t'i përdorur ato mënyra efikase, me më pak investime për të arritur një vëllim më të madh të aktiviteteve afariste.<sup>25</sup>

Më poshtë kemi të paraqitur disa ndarje të raporteve të aktiveve.<sup>26</sup>

**1. Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme** - tregon sa herë arkëtohen mesatarisht gjatë vitit llogaritë e arkëtueshme. Në përgjithësi qarkullimi më i lartë është i indikator i mirë. Treguesi i qarkullimit të kërkesave tregon efikasitetin e përdorimit të kredive që kompania i ka dhënë klientit të saj.

Qëllimi i miratimit të kredive të tilla është rritja e shitjeve, ndërsa mungesa është mundësi që klientët të vonojnë detyrimet kredisë, në kohë dhe në tërësi.<sup>27</sup>

$$Qarkullimi\ i\ llogarive\ të\ arkëtueshme = \frac{Shitjet\ Neto}{Llogaritë\ e\ arkëtueshme\ (kërkesat)}$$

Ky tregues tregon numrin e cikleve gjatë një viti që fillon me shitjeve e mallrave me kredi dhe përfundon me pagesën e tyre, saktësisht sa herë asetet e subjektit që lidhen me arkëtimet shndërrohen në mjete monetare për një vit. Vlera e lartë e këtij treguesi do të thotë se kompania operon në bazë të parave të gatshme ose se kreditë e saj për klientët me mallra dhe mledhje të arkëtimeve janë efektive, ndërsa vlera e ulët tregon se kompania nuk menaxhon mirë debitorët dhe ka nevojë të rivlerisojë politikën e saj të biznesit në mënyrë që të sigurohet grumbullimi në kohë i kredive të dhëna nga të cilat subjekti nuk fiton interes.

Koha mesatare e arkëtimit mat mesatarisht sa kohë i duhet subjektit të arkëtojë llogaritë e arkëtueshme.

$$Koha\ mesatare\ e\ arkëtimit = \frac{365}{Qarkullimi\ i\ llogarive\ të\ arkëtueshme}$$

Ky tregues tregon se sa ditë nevojiten mesatarisht për të rimarrë mallrat e shitura blerësve me kredi.

**2. Qarkullimi i inventarit**- mat efikasitetin e kompanisë dhe shitjen e inventarit. Është matës i likuiditetit të inventarit të kompanisë. Ky tregues na tregon sa shpejtë kompania përdor inventarin në krijimin e produkteve të gatshme dhe shërbimeve të shitjes.

$$Qarkullimi\ i\ inventarit = \frac{Shitjet\ neto\ (KMSH)}{Inventari}$$

Nëse ky koeficient do të ishte 5, do të thotë se rezervat do të realizohen dhe riprodhohen mesatarisht 5 herë në vit. Ky tregues është shumë i rëndësishëm për të gjitha kompanitë, sepse tregon se cilat produkte kanë prodhim të shpejtë ose sa shumë është shitur një produkt. Nëse e ndajmë numrin e ditëve në vit me koeficientin e qarkullimit të inventarëve, do të fitojmë kohëzgjatjen mesatare të një qarkullimi.

$$Kohëzgjatja\ mesatare\ e\ inventarit = \frac{365}{Koeficienti\ i\ qarkullimit\ të\ inventarit}$$

Kur analizohet ky tregues, duhet të merret parasysh natyra e veprimtarisë në të cilën

<sup>25</sup> Georgieva Olivera-Trajkovska, (2010). Analiza na finansiski izveshtai so osvrt na finansiskata stabilnost na korporativniot sektor vo RM. Doktorski Trud, Skopje

<sup>26</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

<sup>27</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

operon kompania dhe procesi i punës në kompani.

**3. Raporti i qarkullimit të detyrimeve ndaj furnitorëve** – një nga aktivitetet më të rëndësishme të çdo subjekti juridik është, natyrisht blerja e materialeve dhe shërbimeve për procesin e prodhimit. Nga këto aktivitete lind detyrimi ndaj furnitorëve për blerjen e pagesës së shtyrë. Është shumë e rëndësishme të përcaktohet koha mesatare në të cilën detyrimet e kanë afatin për t'u paguar gjatë vitit dhe kohë merret nga koeficienti i llogaritur i qarkullimit të furnizimeve.

$$\text{Koeficienti i qarkullimit të furnitorëve} = \frac{\text{Vlera vjetore e furnizimit të materialeve}}{\text{Saldo mesatare e furnitorëve gjatë vitit}}$$

Nëse vlera e këtij raporti do të ishte 5, kjo do të thotë se obligimet ndaj furnizuesve paguhen mesatarisht 5 herë në vit.

Koha mesatare e qarkullimit të llogarive të pagueshme njehson mesatarisht sa kohë i duhet subjektit të paguaj llogaritë e pagueshme (detyrimet).

$$\text{Koha mesatare e pagesës} = \frac{365}{\text{Qarkullimi i llogarive të pagueshme}}$$

Numri i ditëve që merren duke llogaritur koeficientin e mëparshëm tregon kohën mesatare të kthimit.

**4. Raporti i qarkullimit të aktiveve totale** – për të marrë një pasqyrë të përgjithshme të produktivitetit të një kompanie, krahasimi i vlerës së shitjeve të arritura gjatë një periudhe bëhet me asetet totale që kontribuojnë në arritjen e tij.

$$\text{Qarkullimi i aktiveve totale} = \frac{\text{Shitjet neto}}{\text{Totali i aktiveve}}$$

Ky tregues tregon sa herë gjatë vitit asetet e përgjithshme janë konvertuar në shitje. Nëse ky tregues është 2, kjo do të thotë se çdo denar i investuar në totalin e aktiveve gjeneron dy vlera denarë të shitjes. Treguesi i qarkullimit të aktiveve totale gjithashtu vë në dukje strategjinë e çmimit të një kompanie –kompanitë me kufi të ulët fitimi kanë tendencë të kenë një raport të lartë të qarkullimit dhe anasjelltas, ato me marzhë të larta të fitimit kanë një raport të ulët të qarkullimit.

#### 4.4. Raportet e aftësive paguese (solventiteti)

Solveniteti do të thotë aftësia e subjektit për të shlyer shpenzimet e interesit dhe detyrimet afatgjata sipas kontratës brenda afatit të caktuar më parë. Solvenitetin mund ta quajmë edhe si figura financiare afatgjate e subjektit. Si faktorë për atë siguri janë asetet (mjete) d. m. th. vlera dhe struktura e fondeve në dispozicion të kompanisë, struktura e burimeve të financimit ose kapitalit, renatibiliteti i subjektit d. m. th fuqia e tij e fitimit.<sup>28</sup>Treguesit më të rëndësishëm për analizën e sovlanitetit janë: raporti i mbulimit të mjeteve dhe raporti i mbulimit të financimit.

$$\text{Raporti i mbulimit të mjeteve fikse} = \frac{\text{kapitali fiks}}{\text{mjetet fikse}}$$

<sup>28</sup> Stojilković Mladen, Krstić, J.,(2000), Finansijska analiza. Ekonomski fakultet, Nish, Serbi



Mjetet e përhershme paraqesin aktivet afatgjata jo materiale (koncesionet, patentat, liçencat. . . ), mjete fikse (toka, ndërtesa, pajisje etj) dhe investimet financiare afatgjata.

Vlera e këtij koeficienti është rreth 1 d. m. th rreth 100% tregon aftësinë paguese më të favorshme të kompanisë.

$$\text{Raporti i mbulimit të inventarit të kapitalit neto të punës} = \frac{\text{kapitali qarkullues neto}}{\text{detyrimet afatëshkurta}}$$

Kapitali neto i punës përfaqëson pjesë të kapitalit të tij dhe atij të huazuar afatgjatë, të destinuar për financimin e kapitalit qarkullues. Nëse raporti i mbulimit të inventarit të kapitalit qarkullues është negativ, ajo do të thotë që shuma e kapitalit, rezervat afatgjata dhe detyrimet afatgjata janë të pa mjaftueshme për të mbuluar mjetet fikse.

#### 4.5. Treguesit e Rentabilitetit ROI

Çdo e ardhur përfaqëson një rritje aktiveve ose një rënie të detyrimeve, ndërsa shpenzimet paraqesin një rënie në aktivet dhe një rritje të detyrimeve. Dallimi pozitiv midis të ardhurave dhe shpenzimeve të biznesit është fitimi i biznesit që realizohet duke angazhuar aktivet e biznesit që përdoren për kryerjen e aktiviteteve të biznesit. Varësisht nga efikasiteti i përdorimit të aseteve, subjektet ekonomike realizojnë fitim ose humbje.

Qëllimi i çdo subjekti ekonomik është që të maksimizojë fitimet në afat të gjatë dhe qëllimi i ROI është të shoh shkallën e arritjes së qëllimeve të përcaktuara.

ROI-të janë marrdhënie relative në dy pozicione ku llogaritje del fitimi. Në këtë mënyrë kemi disa tregues të rëndësishëm të ROI:<sup>29</sup>

##### a) Aftësia për të gjeneruar fitime nga aktivet gjithsej

$$\text{Raporti i kthimit nga aktivet gjithsej} = \frac{\text{Fitimi neto (EBIT)}}{\text{Aktivet gjithsej}}$$

Qëllimi kryesor i subjektit ekonomik është arritja e shkallës më të lartë të fitimit, duke shpenzuar sa më pak mjete. Në bazë të mjeteve të angazhuara, realizohen të ardhura ose fitimi i mundshëm. Nëse të ardhurat janë më të larta se shpenzimet, atëherë kemi fitim.

##### b) Kthimi nga aktivet

Raporti i fitimit neto mbi aktivet gjithsej mat ROI, pas tatimeve dhe interesave:

$$\text{Kthimi nga aktivet (ROA)} = \frac{\text{Fitimi neto (EAT)}}{\text{Aktivet gjithsej}}$$

Maksimizimi i shkallës së rimbursimit është i mundur nëpërmjet dy varianteve: Rritja e marzhës së fitimit neto / ose rritja e qrkullimit të mjeteve të subjektit.

<sup>29</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

### c ) Kthimi nga kapitali vetanak

Kthimi nga kapitali vetanak ( ROE ) shpreh raportin e fitimit neto mbi kapitalin e vet dhe mat kthimin nga kapitali i vet.

$$Kthimi\ nga\ kapitali\ vetanak\ (ROE) = \frac{Fitimi\ neto\ (EAT)}{Kapitali\ vetanak}$$

Aksionarët investojnë që të kenë një fitim nga paratë e tyre dhe ky raport u tregon atyre në bazë kontabël ecurinë e investimit të tyre.

Me ndihmën e analizës Dipont që përdoret në menaxhimin financiar, vlerësimet bëhen për subjektet ekonomike në bazë të përcaktimit të marrdhënies midis raporteve financiare. Analiza Dippon fillon nga norma e kthimit në kapital (ROE) si një nga treguesit e përgjithshëm të performancës së subjekteve ekonomike.

### ç ) Norma e kthimit të aktiveve totale

$$Norma\ e\ kthimit\ të\ aktiveve\ totale = \frac{Fitimi\ neto}{Të\ hyrat\ nga\ shitja\ x\ Koeficienti\ i\ qarkullimit\ i\ të\ hyrave\ totale}$$

(Koeficienti i qarkullimit i të hyrave totale paraqet koeficientin e fitimit neto dhe të mjeteve totale mesatare).

### d ) Struktura financiare

Koeficienti i strukturës financiare tregon se si secila njësi monetare e kapitalit të vet i ka angazhuar mjetet qarkulluese dhe afatgjata. Në fakt, ai mat masën në të cilën biznesi mbështetet në burimet e huazuara të financimit (detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra).

$$Struktura\ financiare = \frac{Koeficienti\ i\ aktiveve\ mesatare\ të\ subjektit}{Kapitali\ mesatar\ vetanak}$$

## 4.6. Raportet e tregut

Në këtë grup raportesh bëjnë pjesë raportet e tregut që lidhin çmimin e aksioneve të shoqërisë me fitimin, me rrjedhjen e arkës dhe vlerën e shpallur për aksionet e saj<sup>30</sup>. Këto raporte i japin menaxherëve një tregues të vlerësimit të inventarëve për performancën e kaluar të shoqërisë dhe perspektivën e saj në të ardhmen.

Nëse raportet e rentabilitetit, të menaxhimit të aktiveve, të borxhit dhe të likuiditetit janë të kënaqshme, edhe raportet e tregut do të jenë të larta dhe si rrjedhim çmimi i aksioneve pritet të jetë i lartë .

### Raporti çmim/fitim për aksion

Raporti çmim/fitim për aksion (P/E) tregon sa të gatshëm janë investitorët të paguajnë për çdo denarë të fitimit të deklaruar.

<sup>30</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

$$\text{Raporti } \textit{\text{çmim}/fitim} = \frac{\textit{\text{çmimi për aksion}}}{\textit{fitimi për aksion}}$$

### **Raporti çmim/flukse arke për aksion**

Në disa industri çmimi i aksioneve është më i lidhur me flukset e arkës se sa me fitimin neto. Si rrjedhim, investitorët zakonisht e shohin raportin çmim/flukse arke për aksion.<sup>31</sup>

$$\text{Raporti } \textit{\text{çmim}/flukse arke për aksion} = \frac{\textit{\text{çmimi për aksion}}}{\textit{flukset e arkës për aksion}}$$

### **Raporti vlerë tregu/vlerë kontabël për aksion**

Raporti çmim i tregut të aksioneve mbi vlerën e tyre kontabël jep një tregues tjetër për konsideratat e investitorëve për shoqërinë.

$$\text{Vlera kontabël për aksion} = \frac{\textit{Kapitali i pronarit}}{\textit{Aksionet në qarkullim}}$$

Ndërsa kur pjestojmë çmimin e tregut për aksion me vlerë kontabël për aksion, gjejmë raportin çmim tregu –vlerë kotabël.

$$\text{Raporti treg} = \frac{\textit{\text{çmimi i tregut për aksion}}}{\textit{vlera kontabël për aksion}}$$

Nëse një shoqëri ka kthim të ulët nga aktivet, raporti vlerë tregu/vlerë kontabël e saj është më i ulët se një shoqëri mesatare. Sipas përvojave, rezultate të mira kohët e fundit e kanë këtë raport tregu nën 10, ndërsa shoqëritë shumë të sukseshme si Microsoft arrijnë përqindje të lartë të kthimit mbi aktivet, duke shkaktuar që vlera e tregut e tyre të tejkalojë atë kontabël.

<sup>31</sup> Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

#### 4.7. Prezentimi i kompanive në rajonin e Tetovës deri më 31.12.2019

Në rajonin e Tetovës në bazë të entit të statistikës gjatë vitit 2019 i kemi këto të dhëna:

Tabela nr. 4 Kategoritë e subjekteve ekonomike ne rajonin e Tetovës

Kategoria e subjekteve 2019	Nr. i subjekteve aktive	Numri i të punësuarve	Qarkullimi i mjeteve në €
Mikro subjekte	3781	1-9	
Subjekte të vogla	1143	10-50	
Subjekte të mesme	49	51-249	
Subjekte të mëdha	17	250>	
TOTALI	4990		

Burimi: Enti shtetror i statistikës RMV

Sipas nomenklaturës në RMV për kategorizimin e subjekteve gjer më 31. 12. 2019 në rajonin e Tetovës mund të shihet se 75,77% të subjekteve janë mikro subjekte dhe 22,91% subjekte të vogla që tregon se në këtë rajon këto lloje dominojnë që është një indikator edhe i veprimtarisë së tyre, pra tregti dhe shërbime.

Si subjekte për të cilat kam zgjedhur të bëjmë analizë në këtë temë masteri janë: Subjektet prodhuese, subjektet tregtare dhe subjektet shërbyese. Në këtë punim për më tepër të dhëna dhe informata më të sakta janë përfshirë saktësisht 30-40 ndërmarrje të të gjitha madhësive sipas nomenklaturës së RMV për nga madhësia dhe definicioni.

Ndërmarrjet janë klasifikuar në bazë, së pari në mënyrë të përgjithshme sipas kategorizimit të subjekteve për nga madhësia për periudhën 2015-2019.

Tabela nr. 5 Subjektet ekonomike në rajonin e Tetovës Prodhuese, tregtare,shërbyese

	FIRMAT	VEPRIMTARIA	TË HYRAT E PËRGJITHSHME					NUMRI I TË PUNËSUARVE				
			2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019
I	FRIGO TEKNIKA BEI	Prodhuese	15225755	161788924	168891321	194710740	245564935	41	43	43	59	59
	FRIGO TEKNIKA 2000	Prodhuese	202855166	203128460	154894354	107385367	89459107	15	24	24	34	34
	NURO KOMERC	Prodhuese	65703626	67060482	75323361	107511646	127515577	20	20	22	26	33
	UNI FRIGO	Prodhuese	32691892	36849260	58424127	41615078	47932510	15	15	15	17	17
	EURO INVEST ING	Shërbyese	40742047	74282381	79165737	74125992	97021537	15	15	16	11	15
	FRIGO TEKNIKA PLUS	Prodhuese	23244995	24500631	26437393	35412039	43340917	14	14	14	14	14
	SEDRA DOO	Prodhuese	3921882	6758473	8873166	9122902	10936558	10	13	13	13	13
	BESA SHOP	Tregtare/Shërbyese	12891197	26266404	11667330	16151660	27924435	9	9	7	8	12
	NPK SHARRI	Shërbyese	8350802	8200204	8229135	14384182	33850578	11	14	14	13	11
EUSS SECURITY	Shërbyese	6687258	7022978	6154991	6286097	6497603	10	12	10	10	11	
II	REGALL KOMERC	Prodhuese	4850321	6287932	7150147	5229686	5564176	10	9	9	8	9
	SWISS CENTAR	Prodhuese	33461195	36529178	26252210	28230289	30613548	8	6	9	6	8
	NASER KOMPANI	Prodhuese	2779078	2578352	3108505	3301408	2517600	5	5	7	6	8
	PRO INGENERING	Shërbyese	31927081	50370082	40984488	41909967	55157874	8	8	8	8	8
	MUJO KOMPANI	Shërbyese	20631007	8080160	4213835	8080160	4213835	5	6	5	6	7
	JEKA IDEAL	Prodhuese	3257889	14442859	27498981	25438165	30154904	1	2	5	5	7
	FLOOR	Prodhuese/Shërbyese	2525922	2096916	4388172	4432530	6236608	3	5	6	7	7
	DUNLOP	Tregtare	57666479	54280407	73079184	79539074	81255665	10	10	10	8	7
	ABI MOBEL	Prodhuese	11840875	12918034	9398880	10461052	11658928	10	9	9	6	7
SHARR PLANINA	Tregtare	21605710	22850831	15904846	21751438	19795826	6	7	5	6	5	
III	TRROPLIN	Tregtare	14297727	19726638	24739380	32909805	39096938	4	4	4	4	4
	VENECIA MUNISHI	Tregtare	6692092	6874183	7138229	7634158	8264831	4	4	4	4	4
	EURO PIROK FONE	Tregtare/Shërbyese	302575	395000	4321994	4855868	6094300	3	3	3	3	4
	HEBA PROEKT	Shërbyese	3403336	4586625	5129398	44036491	25737278	4	3	5	6	4
	DINOR CONSALTING	Shërbyese	1398462	1606821	1765028	2854537	2931515	4	4	4	4	4
	AGRO REKA	Tregtare/Shërbyese	1028638	2003361	224228	2857250	9684420	2	3	3	3	4
	DANI MB	Tregtare	2544501	2592539	2537556	2986336	6467657	2	2	3	2	3
	EURO PROEKT	Shërbyese	10029330	17256003	14810991	14470619	9104579	2	3	5	3	3
	INTER TOPING	Prodhuese	1224797	3696853	4229342	4488088	8402286	2	2	3	2	3
	UNIMETAL	Prodhuese	12914379	51402316	1351955	16281161	12941992	6	6	4	4	3
	XHIHAN KOMPANI	Shërbyese	937958	4901628	4344445	5394380	5878472	2	3	3	3	3
	NASKO MERMER	Tregtare	14855203	15374018	16641247	16979202	16788158	3	3	3	3	3
	SEMPERIT EZ	Tregtare	4209471	5349697	3492411	5358321	4293421	2	3	3	3	3
	GONI MAGAZIN	Tregtare	3812516	4483254	4039284	4092268	3793625	3	2	3	2	2
	TAFO CERAMIC	Tregtare	2075357	2992364	2712319	3460943	6536993	2	2	2	2	2
	MAKSIT	Tregtare	13250669	12646750	10927889	9255131	2881880	5	3	3	2	2
EURO BETON MIX	Prodhuese	32127346	65360106	55577820	47397520	35487892	2	3	2	2	2	
BETON GROUP	Prodhuese	106087369	20757376	99028688	76116583	84378355	1	1	1	3	2	
NEDO KOMPANI	Tregtare	30796714	35379147	23797816	20388213	14385552	2	1	1	1	1	

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Sipas tabelës së mësipërme në bazë të vepritarisë kemi 16 ndërmarrje prodhuese, 14 ndërmarrje tregtare dhe 9 ndërmarrje shërbyese.

Në tabelën e dhënë më lartë është treguar ndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë, qarkullimit vjetor dhe numrit të punëtorëve në:

- **(I)** janë kompanitë që sipas indikatorëve llogariten në grupin e ndërmarrjeve të mesme – në këtë ndarje janë prezentuar të dhënat e 10 subjekteve ekonomike.

- **(II)** janë kompanitë që sipas indikatorëve llogariten në grupin e ndërmarrjeve të vogla – në këtë ndarje janë prezentuar të dhënat e 10 subjekteve ekonomike.

- **(III)** janë kompanitë që sipas indikatorëve llogariten në grupin e ndërmarrjeve mikro – në këtë ndarje janë prezentuar të dhënat e 19 subjekteve ekonomike.

Më poshtë ndërmarrjet e klasifikuara për nga madhësia, janë të ndara në bazë të këtyre treguesve financiar:

- A) Të hyrave të përgjithshme**
- B) Shpenzimeve të përgjithshme**
- C) Numrit të të punësuarve**
- D) Qarkullimit vjetor – Fitimi/Humbja**
- E) Mesatarja e treguesve financiarë (2019/2015)**

Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë për periudhën e viteve 2015-2019 në bazë të raporteve vjetore financiare duke nxjerrur analizën e trendit për këtë periudhë.

## 4.8. Analiza e trendit në bazë të të hyrave të përgjithshme për periudhën (2015-2019)

Tabela nr. 6 Subjektet ekonomike në bazë të të hyrave


FIRMAT	TË HYRAT E PËRGJITHSHME					ANALIZA E TRENDIT TË TË HYRAVE					Mesatarja/Të hyrat	Trendi Mesatarja /Të hyrat 19/15	
	2015	2016	2017	2018	2019	16/15	17/16	18/17	19/18	19/15			
<b>I</b>	<i>FRIGO TEKNIKA BEI</i>	15225755	161788924	168891321	194710740	245564935	963%	4%	15%	26%	1513%	59259664	12,04%
	<i>FRIGO TEKNIKA 2000</i>	121785516	122978460	154894354	107385367	89459107	1%	26%	-31%	-17%	-27%		
	<i>NURO KOMERC</i>	65703626	67060482	75323361	107511646	127515577	2%	12%	43%	19%	94%		
	<i>UNI FRIGO</i>	32691892	36849260	58424127	41615078	47932510	13%	59%	-29%	15%	47%		
	<i>EURO INVEST ING</i>	40742047	74282381	79165737	74125992	97021537	82%	7%	-6%	31%	138%		
	<i>FRIGO TEKNIKA PLUS</i>	23244995	24500631	26437393	35412039	43340917	5%	8%	34%	22%	86%		
	<i>SEBRA DOO</i>	3921882	6758473	8873166	9122902	10936558	72%	31%	3%	20%	179%		
	<i>BESA SHOP</i>	12891197	26266404	11667330	16151660	27924435	104%	-56%	38%	73%	117%		
	<i>NPK SHARRI</i>	8350802	8200204	8229135	14384182	33850578	-2%	0%	75%	135%	305%		
	<i>EUSS SECURITY</i>	6687258	7022978	6154991	6286097	6497603	5%	-12%	2%	3%	-3%		
<b>II</b>	<i>REGALL KOMERC</i>	4850321	6287932	7150147	5229686	5564176	30%	14%	-27%	6%	15%	217700646	2,97%
	<i>SWISS CENTAR</i>	33461195	36529178	26252210	28230289	30613548	9%	-28%	8%	8%	-9%		
	<i>NASER KOMPANI</i>	2779078	2578352	3108505	3301408	2517600	-7%	21%	6%	-24%	-9%		
	<i>PRO INGENERING</i>	31927081	50370082	40984488	41909967	55157874	58%	-19%	2%	32%	73%		
	<i>MUJO KOMPANI</i>	20631007	8080160	4213835	8080160	4213835	-61%	-48%	92%	-48%	-80%		
	<i>JEKA IDEAL</i>	3257889	14442859	27498981	25438165	30154904	343%	90%	-7%	19%	826%		
	<i>FLOAR</i>	2525922	2096916	4388172	4432530	6236608	-17%	109%	1%	41%	147%		
	<i>DUNLOP</i>	57666479	54280407	73079184	79539074	81255665	-6%	35%	9%	2%	41%		
	<i>ABI MOBEL</i>	11840875	12918034	9398880	10461052	11658928	9%	-27%	11%	11%	-2%		
	<i>SHARR PLANINA</i>	21605710	22850831	15904846	21751438	19795826	6%	-30%	37%	-9%	-8%		
<b>III</b>	<i>TRROPLIN</i>	14297727	19726638	24739380	32909805	39096938	38%	25%	33%	19%	173%	15275265	0,83%
	<i>VENEZIA MUNISHI</i>	6692092	6874183	7138229	7634158	8264831	3%	4%	7%	8%	24%		
	<i>EURO PIROK FONE</i>	302575	395000	4321994	4855868	6094300	31%	994%	12%	26%	1914%		
	<i>HEBA PROJEKT</i>	3403336	4586625	5129398	44036491	25737278	35%	12%	759%	-42%	656%		
	<i>DINOR CONSALTING</i>	1398462	1606821	1765028	2854537	2931515	15%	10%	62%	3%	110%		
	<i>AGRO REKA</i>	1028638	2003361	224228	2857250	9684420	95%	-89%	1174%	239%	841%		
	<i>DANI MB</i>	2544501	2592539	2537556	2986336	6467657	2%	-2%	18%	117%	154%		
	<i>EURO PROJEKT</i>	10029330	17256003	14810991	14470619	9104579	72%	-14%	-2%	-37%	-9%		
	<i>INTER TOPING</i>	1224797	3696853	4229342	4488088	8402286	202%	14%	6%	87%	586%		
	<i>UNIMETAL</i>	12914379	51402316	1351955	16281161	12941992	298%	-97%	1104%	-21%	0%		
	<i>XHIHAN KOMPANI</i>	937958	4901628	4344445	5394380	5878472	423%	-11%	24%	9%	527%		
	<i>NASKO MERMER</i>	14855203	15374018	16641247	16979202	16788158	3%	8%	2%	-1%	13%		
	<i>SEMPERIT EZ</i>	4209471	5349697	3492411	5358321	4293421	27%	-35%	53%	-20%	2%		
	<i>GONI MAGAZIN</i>	3812516	4483254	4039284	4092268	3793625	18%	-10%	1%	-7%	0%		
	<i>TAFO CERAMIC</i>	2075357	2992364	2712319	3460943	6536993	44%	-9%	28%	89%	215%		
	<i>MAKSIT</i>	13250669	12646750	10927889	9255131	2881880	-5%	-14%	-15%	-69%	-78%		
	<i>EURO BETON MIX</i>	32127346	65360106	55577820	47397520	35487892	103%	-15%	-15%	-25%	10%		
	<i>BETON GROUP</i>	106087369	20757376	99028688	76116583	84378355	-80%	377%	-23%	11%	-20%		
	<i>NEDO KOMPANI</i>	30796714	35379147	23797816	20388213	14385552	15%	-33%	-14%	-29%	-53%		

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Tabela më lartë e ndarë në tre grupe të ndërmarrjeve të klasifikuara në bazë të numrit të punëtorëve në vitin 2019 paraqet të gjitha grupet e ndërmarrjeve në bazë të të hyrave të përgjithshme, mesatares së secilit grup dhe trendit të mesatares si përqindje.

Më poshtë do të paraqesim grafikonet për secilin grup të ndërmarrjeve me treguesit financiar në bazë të të hyrave.

**Grafiku nr. 4 Të hyrat e përgjithshme në ndërmarrjet e mesme**




Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Nga grafikoni nr. 4 në grupin e parë të ndërmarrjeve të mesme shihet se 9 nga 10 ndërmarrjet kanë rritje të të hyrave në të gjitha vitet krahasuar me vitin paraprak (me përjashtim të luhatjeve të vogla në secilin nga ndërmarrje).

Të hyrat te ndërmarrjet e mesme në periudhën e analizuar gjatë viteve( 2019 – 2015) kanë rritje pozitive me mesatare prej 12,04 %, përveç rastit te ndërmarrja FRIGO TEKNIKA 2000 që ka rënie të konsiderueshme të të hyrave secilin vit në krahasim me atë paraprak dhe vitin 2019 në krahasim me 2015 ka rënie prej 56%

**Grafikoni nr. 5 Të hyrat e përgjithshme për ndërmarrjet e vogla**




Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Nga Grafikoni nr. 5 Në grupin e dytë të ndërmarrjeve të vogla shihet se të hyrat në këto ndërmarrje në periudhën e analizuar gjatë viteve (2019-2015) tregojnë një rritje pozitive me mesatare prej 2,97%, përveç rastit te ndërmarrja MUJO KOMPANI që ka rënie të konsiderueshme të të hyrave secilin vit në krahasim me atë paraprak dhe vitin 2019 në krahasim me 2015 ka rënie prej 80% .



**Grafiku nr. 6 Të hyrat e përgjithshme në ndërmarrjet mikro**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet “ Dinor Consalting “ Tetovë

Nga Grafikoni nr. 6 Në grupin e tretë të ndërmarrjeve mikro shihet se të hyrat në këto ndërmarrje në periudhën e analizuar gjatë viteve ( 2019-2015 )në bazë të mesatares kemi rritje të të hyrave prej 0,83 %. Kjo rritje e vogël vjen si pasojë e 3 ndërmarrjeve (15. 79%) që kanë vëllim më të madh të hyrave gjë që e prish tendencën pozitive të ndërmarrjeve tjera që janë në numër 16 apo 84. 21%. Marrë në përgjithësi, ndërmarrjet e analizuara që janë objekt i këtij punimi kanë rritje graduale të të hyrave vjet për vjet nga 2015 deri në 2019. Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të analizuara janë 10 apo 25. 64% që kanë rrënie të të hyrave përkundër 29 ndërmarrje apo 74. 36% që kanë rritje të të hyrave.

#### 4.9. Analiza e trendit të shpenzimeve të përgjithshme për periudhën (2015-2019)


Tabela nr. 7 Subjektet ekonomike në bazë të shpenzimeve

FIRMAT	SHPENZIMET E PËRGJITHSHME					ANALIZA E TRENDIT TË SHPENZIMEVE					Mesatarja/ Shpenzimet	Trendi Mesatarja/ Shpenzimet 19/15	
	2015	2016	2017	2018	2019	16/15	17/16	18/17	19/18	19/15			
<b>I</b>	<b>FRIGO TEKNIKA BEI</b>	14355762	135812248	144738522	176662352	226559442	846%	7%	22%	28%	1478%	54879278	9,91%
	<b>FRIGO TEKNIKA 2000</b>	104915766	95410409	129146230	91818149	81751137	-9%	35%	-29%	-11%	-22%		
	<b>NURO KOMERC</b>	63564529	62867525	71427341	100889763	110646624	-1%	14%	41%	10%	74%		
	<b>UNI FRIGO</b>	27545134	33160684	54312641	45734214	39417334	20%	64%	-16%	-14%	43%		
	<b>EURO INVEST ING</b>	28397054	70174077	77527714	73218060	95468122	147%	10%	-6%	30%	236%		
	<b>FRIGO TEKNIKA PLUS</b>	21850963	23500744	19728606	3325729	38867994	8%	-16%	69%	17%	78%		
	<b>SEDRA DOO</b>	40525509	6911540	8017717	8169218	9844364	-83%	16%	2%	21%	-76%		
	<b>BESA SHOP</b>	12124051	25813374	11015832	15398782	24698623	113%	-57%	40%	60%	104%		
	<b>NPK SHARRI</b>	7623061	8107309	8194204	13305323	18337653	6%	1%	62%	38%	141%		
	<b>EUSS SECURITY</b>	6518324	6743796	5922590	6066067	6386321	3%	-12%	2%	5%	-2%		
<b>II</b>	<b>REGALL KOMERC</b>	4529472	6128132	6978754	4982801	5308574	35%	14%	-29%	7%	17%	20106770	3,78%
	<b>SWISS CENTAR</b>	31987020	34061263	22914090	24337299	29795905	6%	-33%	6%	22%	-7%		
	<b>NASER KOMPANI</b>	2700699	2489938	3093262	3222778	2383149	-8%	24%	4%	-26%	-12%		
	<b>PRO INGENERING</b>	28940215	46925577	38816806	39359967	52480667	62%	-17%	1%	33%	81%		
	<b>MUJO KOMPANI</b>	8484899	5934917	3020448	5839992	3020448	-30%	-49%	93%	-48%	-64%		
	<b>JEKA IDEAL</b>	3001850	13186887	24680779	22877853	26535041	339%	87%	-7%	16%	784%		
	<b>FLOOR</b>	2218452	3018910	4138195	4210358	5928170	36%	37%	2%	41%	167%		
	<b>DUNLOP</b>	52709985	50247730	70320312	77779703	74618448	-5%	40%	11%	-4%	42%		
	<b>ABI MOBEL</b>	11083620	11218745	8714978	9205217	10615182	1%	-22%	6%	15%	-4%		
	<b>SHARR PLANINA</b>	21483918	22729495	15799943	21640846	19636816	6%	-30%	37%	-9%	-9%		
<b>III</b>	<b>TRROPLIN</b>	13977110	18972629	24541526	31412730	6847640	36%	29%	28%	-78%	-51%	14638796	0,23%
	<b>VENECIA MUNISHI</b>	6370745	6455666	6602947	7075214	7733250	1%	2%	7%	9%	21%		
	<b>EURO PIROK FONE</b>	281515	370869	4089784	4755047	6051666	32%	1003%	16%	27%	2050%		
	<b>HEBA PROEKT</b>	3125365	4312902	5072475	43557887	25523988	38%	18%	759%	-41%	717%		
	<b>DINOR CONSALTING</b>	1250760	1241483	1497767	2414696	2183806	-1%	21%	61%	-10%	75%		
	<b>AGRO REKA</b>	924347	1966897	715897	2830993	7473776	113%	-64%	295%	164%	709%		
	<b>DANI MB</b>	2336509	2496836	2431953	2886472	6250610	7%	-3%	19%	117%	168%		
	<b>EURO PROEKT</b>	9155644	16520800	14333786	13483189	8405594	80%	-13%	-6%	-38%	-8%		
	<b>INTER TOPING</b>	1162100	3446439	3638344	3545229	6989908	197%	6%	-3%	97%	501%		
	<b>UNIMETAL</b>	11769376	49319453	12728105	15310522	17120140	319%	-74%	20%	12%	45%		
	<b>XHIHAN KOMPANI</b>	864041	3036929	4124763	5563456	4736865	251%	36%	35%	-15%	448%		
	<b>NASKO MERMER</b>	14520199	15007196	16239596	33848284	16649247	3%	8%	108%	-51%	15%		
	<b>SEMPERIT EZ</b>	5245271	3909588	3343013	5076419	4143014	-25%	-14%	52%	-18%	-21%		
	<b>GONI MAGAZIN</b>	3256222	3000714	3403403	3890981	3578505	-8%	13%	14%	-8%	10%		
	<b>TAFO CERAMIC</b>	2012299	2846871	2504407	3292494	5983860	41%	-12%	31%	82%	197%		
	<b>MAKSIT</b>	11550369	11750147	10860129	9046016	2605504	2%	-8%	-17%	-71%	-77%		
	<b>EURO BETON MIX</b>	31362731	63478657	54040941	45510809	33525286	102%	-15%	-16%	-26%	7%		
	<b>BETON GROUP</b>	104179566	20584180	98114991	75545829	83461629	-80%	377%	-23%	10%	-20%		
	<b>NEDO KOMPANI</b>	27689651	32002347	21887248	17511272	12938267	16%	-32%	-20%	-26%	-53%		

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Nga tabela e shpenzimeve të paraqitur më lartë vërehet se në përgjithësi ka luhatje më të mëdha dhe ka rritje më të vogël të shpenzimeve. Tek të gjitha llojet e ndermarjeve të analizuar kemi rritje të mesatares të shpenzimeve prej 9,91% tek ndërmarrjet e mesme për periudhën analizuar (2019-2015), tek ndermarjet e vogla 3. 78% dhe tek ndermarjet mikro kemi rritje prej 0. 23%.


**Grafiku nr. 7 Shpenzimet e përgjithshme në ndërmarrjet e mesme**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet “ Dinor Consalting ” Tetovë

Në Grafikon nr. 7 Shpenzimet e përgjithshme tek ndërmarrjet e mesme kanë tendecë rritjeje por gjithmonë duke i ndjekur të hyrat. Tek shpenzimet e këtyre ndërmarrjeve kemi luhatje më të mëdha duke analizuar periudhën (2019-2015). Ulje të shpenzimeve vërehet te 30% e ndërmarrjeve, 40% e ndërmarrjeve kanë trend rritës të mesatares të shpenzimeve më shumë se dyfishi për periudhën e analizuar, ndërsa 30% e ndërmarrjeve kanë rritje mesatare mbi 50%.


**Grafiku nr. 8 Shpenzimet e përgjithshme në ndërmarrjet e vogla**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet “ Dinor Consalting ” Tetovë

Në Grafikon nr. 8 të shpenzimeve të përgjithshme tek ndërmarrjet e vogla tregon tendecë të balancuar. Ulja e shpenzimeve që paraqitet tek 50% e ndërmarrjeve është e moderuar. Rritja e shpenzimeve per 20% të ndërmarrjeve është e shumëfishuar, ndërsa per 30% te ndërmarrjeve shpenzimet janë afër 50%.

**Grafikoni nr. 9 Shpenzimet e përgjithshme në ndërmarrjet mikro**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Në grafikun nr. 9 të shpenzimeve të përgjithshme tek ndërmarrjet mikro tregon tendecë të luhatjeve të mëdha. Ulja e shpenzimeve që paraqitet tek 31. 58% e ndërmarrjeve është e moderuar. Rritja e shpenzimeve per 36. 84% të ndërmarrjeve është e shumëfishuar nga ku vërejmë shembullin e ndërmarrjes Euro Pirok Fone (+2050%), ndersa per 31. 58% te ndërmarrjeve shpenzimet janë afër 29%.

#### 4.10. Anaiza e trendit në bazë të numrit të të punsuarve për periudhën (2015-2019)

Tabela nr.8 Subjektet ekonomike në bazë të të punsuarve


FIRMAT	NUMRI I TË PUNËSUARVE					ANALIZA E TRENDIT TË PUNËTORËVE					Mesatarja/ Nr.punt	Trendi Mesatarja/ Nr.punt 19/15	
	2015	2016	2017	2018	2019	16/15	17/16	18/17	19/18	19/15			
I	FRIGO TEKNIKA BEI	41	43	43	59	59	5%	0%	37%	0%	44%	19	3,69%
	FRIGO TEKNIKA 2000	15	24	24	34	34	60%	0%	42%	0%	127%		
	NURO KOMERC	20	20	22	26	33	0%	10%	18%	27%	65%		
	UNI FRIGO	15	15	15	17	17	0%	0%	13%	0%	13%		
	EURO INVEST ING	15	15	16	11	15	0%	7%	-31%	36%	0%		
	FRIGO TEKNIKA PLUS	14	14	14	14	14	0%	0%	0%	0%	0%		
	SEDRA DOO	10	13	13	13	13	30%	0%	0%	0%	30%		
	BESA SHOP	9	9	7	8	12	0%	-22%	14%	50%	33%		
	NPK SHARRI	11	14	14	13	11	27%	0%	-7%	-15%	0%		
	EUSS SECURITY	10	12	10	10	11	20%	-17%	0%	10%	10%		
II	REGALL KOMERC	10	9	9	8	9	-10%	0%	-11%	13%	-10%	7	1,06%
	SWISS CENTAR	8	6	9	6	8	-25%	50%	-33%	33%	0%		
	NASER KOMPANI	5	5	7	6	8	0%	40%	-14%	33%	60%		
	PRO INGENERING	8	8	8	8	8	0%	0%	0%	0%	0%		
	MUJO KOMPANI	5	6	5	6	7	20%	-17%	20%	17%	40%		
	JEKA IDEAL	1	2	5	5	7	100%	150%	0%	40%	600%		
	FLOOR	3	5	6	7	7	67%	20%	17%	0%	133%		
	DUNLOP	10	10	10	8	7	0%	0%	-20%	-13%	-30%		
	ABI MOBEL	10	9	9	6	7	-10%	0%	-33%	17%	-30%		
	SHARR PLANINA	6	7	5	6	5	17%	-29%	20%	-17%	-17%		
III	TRROPLIN	4	4	4	4	4	0%	0%	0%	0%	0%	3	0,10%
	VENECIA MUNISHI	4	4	4	4	4	0%	0%	0%	0%	0%		
	EURO PIROK FONE	3	3	3	3	4	0%	0%	0%	33%	33%		
	HEBA PROEKT	4	3	5	6	4	-25%	67%	20%	-33%	0%		
	DINOR CONSALTING	4	4	4	4	4	0%	0%	0%	0%	0%		
	AGRO REKA	2	3	3	3	4	50%	0%	0%	33%	100%		
	DANI MB	2	2	3	2	3	0%	50%	-33%	50%	50%		
	EURO PROEKT	2	3	5	3	3	50%	67%	-40%	0%	50%		
	INTER TOPING	2	2	3	2	3	0%	50%	-33%	50%	50%		
	UNIMETAL	6	6	4	4	3	0%	-33%	0%	-25%	-50%		
	XHIHAN KOMPANI	2	3	3	3	3	50%	0%	0%	0%	50%		
	NASKO MERMER	3	3	3	3	3	0%	0%	0%	0%	0%		
	SEMPERIT EZ	2	3	3	3	3	50%	0%	0%	0%	50%		
	GONI MAGAZIN	3	2	3	2	2	-33%	50%	-33%	0%	-33%		
	TAFO CERAMIC	2	2	2	2	2	0%	0%	0%	0%	0%		
	MAKSIT	5	3	3	2	2	-40%	0%	-33%	0%	-60%		
	EURO BETON MIX	2	3	2	2	2	50%	-33%	0%	0%	0%		
	BETON GROUP	1	1	1	3	2	0%	0%	200%	-33%	100%		
	NEDO KOMPANI	2	1	1	1	1	-50%	0%	0%	0%	-50%		

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Në tabelën nr. 8 në bazë të analizës së trendit kemi të paraqitur mesataren e numrit të punëtorëve gjat periudhës (2015-2019) sipas mesatares së numrit të të punësuarve është bërë edhe kategorizimi i ndërmarrjeve në të mesme, të vogla dhe mikro. Në grupin e parë të ndërmarrjeve kemi një rritje graduale të të punësuarve prej vitit 2015 deri me 2019 është rritur 3.69% dhe ato mesatarisht kanë nga 19 të punësuar, në ndërmarrjet mikro është rritur 1.06% dhe ato mesatarisht kanë nga 7 të punësuar, në ndërmarrjet e vogla është rritur 0.10% dhe ato

mesatarisht kanë nga 3 të punësuar.


**Grafikoni nr. 10 Numri i të punësuarve në ndërmarrjet e mesme**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Në Grafikon nr. 10 të numrit të të punësuarve tek ndërmarrjet e mesme nuk paraqitet me dallime të mëdha, por në përgjithësi ka përqindje të vogël pozitive në të gjitha ndërmarrjet e analizuar. Dallim në këtë rast kemi vetëm tek ndërmarrja FRIGO TEKNIKA 2000 tek e cila në vitin 2019 në krahasim me 2015 ka rritje të numrit të punëtorëve prej 127%.


**Grafikoni nr. 11 Numri i të punësuarve në ndërmarrjet e vogla**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Në Grafikon nr. 11 ku numri i të të punësuarve tek ndërmarrjet e vogla paraqitet me luhajtje më të theksuar, por në përgjithësi ka përqindje shumë të vogël pozitive në të gjitha ndërmarrjet e analizuar. Në këtë grup të ndërmarrjeve 40 % kanë zvogëlim të numrit të punëtorëve me një përqindje mesatare prej 21.75%, dy ndërmarrje apo 20% janë me numër të pandryshueshëm të punëtorëve dhe pjesa tjetër apo 40% kanë rritje të numrit të punëtorëve (dy ndërmarrje kanë dyfishuar apo më tepër numrin e punëtorëve).

**Grafikoni nr. 12 Numri i të punësuarve në ndërmarrjet mikro**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Nga Grafiku i numrit të të punësuarve tek ndërmarrjet mikro paraqitet me zvogëlim, rritje dhe numër konstant të të punësuarve dhe në përgjithësi ka mesatare shumë të vogël pozitive në të gjitha ndërmarrjet e analizuar. Në këtë grup të ndërmarrjeve 21 % kanë përgjysmim të numrit të punëtorëve, 7 ndërmarrje apo afër 37% janë me numër të pandryshueshëm të punëtorëve dhe pjesa tjetër apo 42% kanë rritje të numrit të punëtorëve me një mesatare prej afro 60%.

Tabela nr.9 Fitimi neto për punëtor dhe rroga neto për punëtor.


FIRMAT	FITIMI PËR PUNËTOR					RROGAT NETO PËR PUNËTORË					Mesatarja /Rrogat	Trendi Mesatarja /Rrogat 19/15	Mesatarja/fitimi puntor	Trendi Mesatarja/fitimi puntor 19/15	
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019					
I	FRIGO TEKNIKA BEI	19097	543698	505524	275299	289914	3958600	4123033	5719084	8842046	8842042	2884523	9,17%	241148	18,16%
	FRIGO TEKNIKA 2000	1124650	1033802	965555	412956	203946	2581978	3323632	3709635	4876513	3709635				
	NURO KOMERC	96259	188683	159382	229065	460071	2526398	2862044	3756025	3749000	5195805				
	UNI FRIGO	343117	221315	246689	116351	116380	2280500	2280500	2280500	2507966	5195805				
	EURO INVEST ING	814910	246498	92139	74285	103561	1685721	2149111	1985338	1641214	2516136				
	FRIGO TEKNIKA PLUS	89616	64278	431279	134120	287545	2012830	2012830	2012830	2012830	2012830				
	SEDRA DOO	-60363	-11774	59223	66024	75613	1293045	1576310	2015310	1707900	2157876				
	BESA SHOP	85238	45303	83764	84699	241936	575462	1251500	1307520	887523	1651021				
	NPK SHARRI	59630	5972	2246	74690	1269239	2131721	2966110	2744800	6394233	5984646				
	EUSS SECURITY	15204	20939	20916	19803	9105	1271060	1324500	1425310	1512000	1685870				
II	REGALL KOMERC	14382	32085	17138	27775	25560	1205560	1013200	1251000	1263600	1437250	966481	3,59%	230061	-54,54%
	SWISS CENTAR	184272	370187	333812	583949	91985	123135	1108300	810743	1080000	1054271				
	NASER KOMPANI	14108	17682	2178	11795	11703	418020	138270	819000	981000	659060				
	PRO INGENERING	373358	387500	243864	286875	301186	1392459	1392459	1615457	1564986	1564986				
	MUJO KOMPANI	2429222	32170	214810	321787	153435	486482	823500	822500	822500	884045				
	JEKA IDEAL	230705	565188	507276	460856	465411	121233	149430	292730	735405	1012250				
	FLOOR	92241	28597	37497	28588	39656	396010	572000	719105	889000	959682				
	DUNLOP	495649	362941	255983	197929	513335	1142720	1067391	1419298	1104848	1356300				
	ABI MOBEL	68153	169929	128361	113984	149107	1980000	1079200	1291703	1296000	1076476				
	SHARR PLANINA	20299	17334	20980	18432	31802	830487	1067000	923970	1114000	996023				
III	TRROPLIN	72139	76002	49013	374269	562325	544800	544800	561600	583200	669900	405601	1,16%	328502	37,66%
	VENECIA MUNISHI	72303	94166	120439	119606	125763	484001	547044	580684	588000	659000				
	EURO PIROK FONE	6318	8044	77403	33607	10659	34050	34050	293150	363600	489600				
	HEBA PROEKT	59888	91241	11385	79767	53323	542993	638825	465411	1009827	799476				
	DINOR CONSALTING	33233	91335	66815	102824	186927	498255	595700	600000	620000	711693				
	AGRO REKA	46931	121488	536110	8752	141620	205500	253600	52336	206396	444640				
	DANI MB	93597	43067	35201	49932	65114	297105	294783	444672	396000	494250				
	EURO PROEKT	393159	220561	48334	296229	182701	752148	950725	1086258	1048749	69800				
	INTER TOPING	28214	112687	206367	424287	3757047	198818	264000	390000	294994	365439				
	UNIMETAL	171750	312430	178056	218394	-1392716	621600	529100	489236	436956	420590				
	XHIHAN KOMPANI	32813	605228	65905	249277	342482	187350	467149	413300	465500	486020				
	NASKO MERMER	100501	110047	133885	36706	46064	403000	403000	414539	400500	467616				
	SEMPERIT EZ	46992	89968	45019	84571	45122	267705	363000	571000	432000	494250				
	GONI MAGAZIN	166888	741270	211960	100824	107560	305750	351850	280800	291601	176400				
	TAFU CERAMIC	28376	47747	103956	248910	75802	186125	273522	273138	258000	335500				
	MAKSIT	306054	268981	20328	1063729	138188	465312	409104	409104	298294	305500				
	EURO BETON MIX	344077	564435	691596	853520	883173	412500	732570	127300	24000	660620				
	BETON GROUP	1717023	155876	822327	171226	412527	74000	23940	111000	107000	30000				
	NEDO KOMPANI	1398179	3039120	1719512	2589247	1302556	264105	209000	139000	144000	149750				

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Në tabelën nr. 9 kemi paraqitur fitimin për punëtor dhe neto rrogën për puntorët për periudhën 2015-2019 për ndërmarrjet e analizuar, neto rroga mesatare në vend ka pasur ndryshime nga viti në vit me rritje të rrogës neto mesatare, në grupin e parë të ndërmarrjeve kemi një mesatare prej 2884523 që do të thotë 9.17% rritje prej vitit 2015 në vitin 2019, dhe mestarja e fitimi për punëtor prej 241148 ose 18,16%, në ndërmarrjet e vogla një mesatare prej 966481 që do të thotë 3,59% rritje prej vitit 2015 në vitin 2019 dhe fitimi për punëtorë 230061 ose -54,54% rrenie dhe ndërmarrjet e vogla rritja mesatare ka qenë 405601 që do të thotë 1,16% prej vitit 2015 në vitin 2019 dhe fitimi për punëtor 328502 ose 37,66% në rritje.




### Grafiku nr. 13 Rroga neto për puntor në ndërmarrjet e mesme



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Në grafikun nr. 13 Tek këto ndërmarrje nga të dhënat e tabelës së përgjithshme shohim se ka rritje trendit të mesatares së rrogave prej 9. 17% dhe gjithashtu rritje të numrit të të punësuarve por rritja e trendit të mesatares ndodh vetëm se rroga minimale në shtet është rritur dhe jo për ndonjë shkak tjetër.


### Grafiku nr. 14 Rroga neto për puntorë në ndërmarrjet e vogla



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Në grafikun nr. 14 Tek ndërmarrjet e vogla nga të dhënat e tabelës së përgjithshme vërehet rritje trendit të mesatares së rrogave prej 3. 59%. Gjithashtu rritja e rrogës minimale në shtet ka ndikim në këtë rritje por këtu kemi luhatje më të mëdha të numrit të punëtorëve gjë që ka ndikim në këtë rritje.

**Grafiku nr. 15 Rroga neto në ndërmarrjet mikro**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet “ Dinor Consalting ” Tetovë

Nga Grafiku nr. 15 tek ndërmarrjet mikro nga të dhënat e tabelës së përgjithshme vërehet dhe grafikoni rritje trendit të mesatares së rrogave prej 1.16%. Lohatja e numrit të punëtorëve (nga grafikoni i numrit të të punësuarve paraqitur më lartë) që është e evidente tek këto ndërmarrje ka ndikuar në përqindjen e vogël të rritjes.

#### 4.11. Analiza e trendit në bazë të qarkullimit vjetor –Fitim/Humbje për periudhën (2015-2019)


Tabela nr. 10 Subjektet ekonomike në bazë të Fitimit Neto

	FIRMAT	FITIMI NETO						Mesatarja /Fitimi Neto	Trendi Mesatarja/Fitimi Neto
		2015	2016	2017	2018	2019	2019/2015		
I	FRIGO TEKNIKA BEI	782994	23379009	21737519	16242650	17104944	2084,56%	5384301	6,52%
	FRIGO TEKNIKA 2000	16869750	24811246	23173312	14040496	6934172	-58,90%		
	NURO KOMERC	1925189	3773661	3506413	5955695	15182328	688,61%		
	UNI FRIGO	5146758	3319718	3700337	1977970	1978467	-61,56%		
	EURO INVEST ING	12223648	3697474	1474221	817139	1553415	-87,29%		
	FRIGO TEKNIKA PLUS	1254629	899898	6037908	1877679	4025631	220,86%		
	SEDRA DOO	-603627	-153067	769904	858316	982975	-262,84%		
	BESA SHOP	767146	407727	586348	677590	2903231	278,45%		
	NPK SHARRI	655929	83605	31438	970973	13961632	2028,53%		
	EUSS SECURITY	152041	251264	209161	198027	100154	-34,13%		
II	REGALL KOMERC	143820	288765	154245	222199	230042	59,95%	1481860	-4,42%
	SWISS CENTAR	1474175	2221124	3004308	3503691	735879	-50,08%		
	NASER KOMPANI	70541	88411	15243	70767	93621	32,72%		
	PRO INGENERING	2986866	3100000	1950914	2295000	2409486	-19,33%		
	MUJO KOMPANI	12146108	193019	1074048	1930719	1074048	-91,16%		
	JEKA IDEAL	230705	1130375	2536382	2304281	3257877	1312,14%		
	FLOOR	276723	142986	224979	200117	277594	0,31%		
	DUNLOP	4956494	3629409	2559833	1583434	3593344	-27,50%		
	ABI MOBEL	681530	1529360	1155251	683902	1043746	53,15%		
	SHARR PLANINA	121792	121336	104898	110592	159010	30,56%		
III	TRROPLIN	288555	304009	196050	1497075	2249298	679,50%	712137	3,45%
	VENECIA MUNISHI	289212	376665	481754	478423	503050	73,94%		
	EURO PIROK FONE	18954	24131	232210	100821	42634	124,93%		
	HEBA PROEKT	239551	273723	56924	478604	213290	-10,96%		
	DINOR CONSALTING	132932	365338	267261	411296	747709	462,47%		
	AGRO REKA	93862	364464	1608331	26257	566481	503,53%		
	DANI MB	187193	86133	105603	99864	195342	4,35%		
	EURO PROEKT	786317	661683	241672	888687	548103	-30,29%		
	INTER TOPING	56428	225373	619101	848574	11271140	19874,37%		
	UNIMETAL	1030501	1874577	712225	873575	-4178148	-505,45%		
	XHIHAN KOMPANI	65625	1815683	197714	747832	1027446	1465,63%		
	NASKO MERMER	301504	330140	401654	110119	138191	-54,17%		
	SEMPERIT EZ	93984	269904	135058	253712	135366	44,03%		
	GONI MAGAZIN	500665	1482540	635881	201647	215120	-57,03%		
	TAFO CERAMIC	56752	95493	207912	497820	151604	167,13%		
	MAKSIT	1530270	806943	60984	2127457	276376	-81,94%		
	EURO BETON MIX	688154	1693304	1383191	1707040	1766345	156,68%		
BETON GROUP	1717023	155876	822327	513679	825053	-51,95%			
NEDO KOMPANI	2796357	3039120	1719512	2589247	1302556	-53,42%			

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Në tabelën e dhënë më lart që paraqet fitimin neto të ndërmarrjeve në përgjithësi dhe trendin e mesatares/fitimin neto. Mund të shohim se kemi rritje pra fitim dhe zvogëlim pra humbje tek ndërmarrjet e analizuar. Në grupin e ndërmarrjeve të mesme për periudhën e analizuar 2015-2019 kemi rritje prej 6. 52%, tek ndërmarrjet e vogla kemi trend negativ prej -4. 42% dhe tek ndërmarrjet mikro kemi fitim prej 3. 45% në përgjithësi.


**Grafiku nr. 16 Fitimi neto për ndërmarrjet e mesme**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Grafiku i dhënë më lart paraqet fitimin neto për ndërmarrjet e mesme. Këtu në përgjithësi kemi trend pozitiv apo rritje të mesatares së fitimit neto që është 6. 52%. Nga ndërmarrjet e analizuar 50 % kanë treguar fitim ( 2 prej tyre kanë treguar fitim neto afër 20-fishin në v. 2019 në krahasim me 2015), 50% kanë treguar humbje mesatare prej afër pesëfishin në vitin 2019.


**Grafiku nr. 17 Fitimi neto për ndërmarrjet e vogla**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë

Grafiku i fitimit neto për ndërmarrjet e vogla tregon humbje prej 4. 42% të trendit të mesatares. Prej të dhënave shohim se 40% e ndërmarrjeve kanë paraqitur humbje mesatarisht 47%, 10% janë me rritje të pakonsiderueshme prej afër 0. 5%, 10% të ndërmarrjeve kanë rritje të shumëfishuar (13-fish) dhe pjesa tjetër prej 40% kanë rritje mesatare prej 176%.

Grafiku nr. 18 Fitimi neto në ndërmarrjet mikro



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet “ Dinor Consalting “ Tetovë


Grafiku i fitimit neto për ndërmarrjet mikro tregon fitim neto prej 3.45% të trendit të mesatares. Prej të dhënave shohim se ka një luhatje shumë të madhe ndërmjet kompanive që tregon se kemi ndërmarrje me rritje shumë të madhe, rritje e moderuar dhe humbje tek disa prej tyre. Humbje me mesatare prej 105% apo përgjysmim të fitimit kanë treguar 42% e ndërmarrjeve, 16% të ndërmarrjeve kanë shumëfishuar fitimin e tyre neto në v. 2019 në krahasim me 2015 dhe pjesa tjetër prej 42% e ndërmarrjeve kanë më tepër se dyfish të fitimit neto rritje.

Tabela nr. 11 Subjektet ekonomike në bazë të tatimit në fitim

	FIRMAT	TATIMI NË FITIM					2019/ 2015	Mesatarja / Tatimi në fitim	Trendi Mesatarja / Tatimi në fitim
		2015	2016	2017	2018	2019			
I	FRIGO TEKNIKA BEI	869993	25976676	24152799	18048388	19005493	2085%	598256	6,52%
	FRIGO TEKNIKA 2000	2939400	1272677	25748124	15567218	7707970	162%		
	NURO KOMERC	2139097	4192957	3896020	6621883	16868953	689%		
	UNI FRIGO	5146758	3688576	4111486	-4119136	8515176	65%		
	EURO INVEST ING	12344993	4108304	1638023	907932	1553415	-87%		
	FRIGO TEKNIKA PLUS	1394032	999887	6708787	2086310	4472923	221%		
	SEDRA DOO	-36603627	-153067	855449	953684	1092194	-103%		
	BESA SHOP	767146	453030	651498	752878	3225812	320%		
	NPK SHARRI	727741	92895	34931	1078859	15512925	2032%		
EUSS SECURITY	168934	279182	232401	220030	111282	-34%			
II	REGALL KOMERC	320849	159800	171393	246885	255602	-20%	164651	-4,42%
	SWISS CENTAR	1474175	2467915	3338120	3892990	817643	-45%		
	NASER KOMPANI	78379	88414	15243	78630	134451	72%		
	PRO INGENERING	2986866	3444505	2167682	2550000	2677207	-10%		
	MUJO KOMPANI	12146108	2145243	1193387	2240168	1193387	-90%		
	JEKA IDEAL	256039	1255972	2818202	2560312	3619863	1314%		
	FLOOR	307470	-921994	249977	222172	308438	0%		
	DUNLOP	4956494	4032677	2758872	1759371	6637217	34%		
	ABI MOBEL	757255	1699289	683902	1255835	1043746	38%		
	SHARR PLANINA	121792	121336	104903	110592	159010	31%		
III	TRROPLIN	320617	754009	197854	1497075	32249298	9959%	260427	-4,17%
	VENECIA MUNISHI	321347	418517	535282	558944	531581	65%		
	EURO PIROK FONE	21060	24131	232210	100821	42634	102%		
	HEBA PROEKT	277971	273723	56923	478604	213290	-23%		
	DINOR CONSALTING	147702	365338	267261	439841	747709	406%		
	AGRO REKA	104291	36464	-491669	26257	2210644	2020%		
	DANI MB	207992	95703	105603	99864	217047	4%		
	EURO PROEKT	873686	735203	477205	987430	698985	-20%		
	INTER TOPING	62697	250414	590998	942859	1412378	2153%		
	UNIMETAL	1145003	2082863	-11376150	970639	-4178148	-465%		
	XHIHAN KOMPANI	73917	1864699	219682	-169076	1141607	1444%		
	NASKO MERMER	335004	366822	401651	-16869082	138911	-59%		
	SEMPERIT EZ	-1035800	1440109	149398	281902	150407	-115%		
	GONI MAGAZIN	556294	1482540	635881	201287	215120	-61%		
	TAFO CERAMIC	63058	145493	207912	168449	553133	777%		
	MAKSIT	1700300	896603	67760	209115	276376	-84%		
	EURO BETON MIX	764615	1881449	1536879	1886711	1962606	157%		
BETON GROUP	1907803	173196	913697	570754	916726	-52%			
NEDO KOMPANI	3107063	3376800	1910568	2876941	1447285	-53%			

Tabela nr. 11 më lartë tregon tatimin në fitim të të gjitha grupeve të ndërmarrjeve dhe trendin e mesatares së tatimit në fitim. Norma tatimore në kuadër të fitimit të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 10%. Nga tabela vërejmë se në grupin e ndërmarrjeve të mesme kemi një mesatare prej 598256 që do të thotë 6,52% prej vitit 2015 në krahasim me vitin 2019, në ndërmarrjet e vogla kemi një mesatare 164651 që do të thotë -4,42% dhe në ndërmarrjet mikro 260427 që do të thote -4,17%.


**Grafiku nr. 19 Tatimi në fitim për ndërmarrjet e mesme**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Grafiku i dhënë më lart paraqet tatimin në fitim tek ndërmarrjet e mesme. Me gjithë luhatjet gjatë viteve të analizuar për këto lloj ndërmarrjesh, në përgjithësi paraqitet trend pozitiv apo rritje të mesatares së fitimit neto që është 6. 52%. Nga ndërmarrjet e analizuar 30 % kanë treguar zvogëlim të tatimit në fitim me një mesatare prej 74. 6% për periudhën 2015-2019. Trend të rritjes të tatimit në fitim kanë treguar tetë ndërmarrje prej të cilave 90% kanë shumëfishuar fitimin neto gjë që direkt ka ndikuar edhe në tatimin në fitim.

**Grafiku nr. 20 Tatimi në fitim për ndërmarrjet e vogla**




Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet "Dinor Consalting" Tetovë

Grafiku i dhënë i tatimit në fitim në ndërmarrjet e vogla paraqet detyrimet e ndërmarrjeve për tatim në fitim ndaj shtetit dhe direkt si indikator i performancës së tyre gjatë viteve. Vërehen luhatje të mëdha gjatë periudhës, si tek ndërmarrjet që paraqesin zvogëlim të tatimit në fitim ashtu edhe tek ato që kanë paraqitur rritje. Zvogëlim të tatimit në fitim kanë treguar 40% e ndërmarrjeve të analizuar më një mesatare të përgjithshme prej 41. 25%, trend neutral

apo pa luhatje në vitin 2019 në krahasim me vitin 2015 ka paraqit një ndërmarrje dhe pjesa tjetër apo 50% e ndërmarrjeve në bazë të raporteve financiare paraqesin rritje të tatimit në fitim në përgjithësi.

**Grafiku nr. 21 Fitimi neto në ndërmarrjet mikro**



Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet “ Dinor Consalting “ Tetovë

Në grafikun nr. 21 tek ndërmarrjet mikro paraqiten të dhënat nga raportet financiare. Vërehet se trendi i mesatares është negativ me një zvogëlim prej 4.17% të tatimit në fitim.

Zvogëlim të tatimit në fitim kanë paraqitur 47% të ndërmarrjeve të analizuara me një mesatare prej 103.5% por me luhatje brenda periudhës. Rritje të tatimit në fitim paraqesin 53% e ndërmarrjeve prej të cilave katër (4) ndërmarrje kanë rritje të tatimit në fitim më tepër se 10-fishin e tyre ndërsa pjesa tjetër me një mesatare të rritjes së tatimit në fitim më tepër se dyfishin apo 252%.

#### 4.12. Mesatarja e treguesve financiar per periudhën (2015-2019)

Tabela nr. 12 Subjektet ekonomike në bazë të treguesve financiar(mesatarja)

	FIRMAT	VEPRIMTARIA	Mesatarja/T ë hyrat	Mesatarja/ Shpenzimet	Mesatarja të hyrat /totali mesatare %	Mesatarja shpenzimet /totali mesatare %	Shpenzimet si %/ të hyrat
I	FRIGO TEKNIKA BEI	Prodhuese	157236335	139625665	26,53%	25,44%	88,80%
	FRIGO TEKNIKA 2000	Prodhuese	151544491	140897413	25,57%	25,67%	92,97%
	NURO KOMERC	Prodhuese	88622938	81879156	14,96%	14,92%	92,39%
	UNI FRIGO	Prodhuese	43502573	40034001	7,34%	7,29%	92,03%
	EURO INVEST ING	Shërbyese	73067539	68957005	12,33%	12,57%	94,37%
	FRIGO TEKNIKA PLUS	Prodhuese	30587195	27454807	5,16%	5,00%	89,76%
	SEDRA DOO	Prodhuese	7922596	14693670	1,34%	2,68%	185,47%
	BESA SHOP	Tregtare/Shërbyese	18980205	17810132	3,20%	3,25%	93,84%
	NPK SHARRI	Shërbyese	14602980	11113510	2,46%	2,03%	76,10%
	EUSS SECURITY	Shërbyese	6529785	6327420	1,10%	1,15%	96,90%
<b>Mesatarja e grupit I</b>			<b>59259664</b>	<b>54879278</b>			
II	REGALL KOMERC	Prodhuese	5816452	5585547	2,67%	2,78%	96,03%
	SWISS CENTAR	Prodhuese	31017284	28619115	14,25%	14,23%	92,27%
	NASER KOMPANI	Prodhuese	2856989	2777965	1,31%	1,38%	97,23%
	PRO INGENERING	Shërbyese	44069898	41304646	20,24%	20,54%	93,73%
	MUJO KOMPANI	Shërbyese	9043799	5260141	4,15%	2,62%	58,16%
	JEKA IDEAL	Prodhuese	20158560	18056482	9,26%	8,98%	89,57%
	FLOOR	Prodhuese/Shërb.	3936030	3902817	1,81%	1,94%	99,16%
	DUNLOP	Tregtare	69164162	65135236	31,77%	32,39%	94,17%
	ABI MOBEL	Prodhuese	11255554	10167548	5,17%	5,06%	90,33%
	SHARR PLANINA	Tregtare	20381730	20258204	9,36%	10,08%	99,39%
<b>Mesatarja e grupit II</b>			<b>21770046</b>	<b>20106770</b>			
III	TRROPLIN	Tregtare	26154098	19150327	9,01%	6,89%	73,22%
	VENECIA MUNISHI	Tregtare	7320699	6847564	2,52%	2,46%	93,54%
	EURO PIROK FONE	Tregtare/Shërbyese	3193947	3109776	1,10%	1,12%	97,36%
	HEBA PROEKT	Shërbyese	16578626	16318523	5,71%	5,87%	98,43%
	DINOR CONSALTING	Shërbyese	2111273	1717702	0,73%	0,62%	81,36%
	AGRO REKA	Tregtare/Shërbyese	3159579	2782382	1,09%	1,00%	88,06%
	DANI MB	Tregtare	3425718	3280476	1,18%	1,18%	95,76%
	EURO PROEKT	Shërbyese	13134304	12379803	4,53%	4,45%	94,26%
	INTER TOPING	Prodhuese	4408273	3756404	1,52%	1,35%	85,21%
	UNIMETAL	Prodhuese	18978361	21249519	6,54%	7,64%	111,97%
	XHIHAN KOMPANI	Shërbyese	4291377	3665211	1,48%	1,32%	85,41%
	NASKO MERMER	Tregtare	16127566	19252904	5,56%	6,92%	119,38%
	SEMPERIT EZ	Tregtare	4540664	4343461	1,56%	1,56%	95,66%
	GONI MAGAZIN	Tregtare	4044189	3425965	1,39%	1,23%	84,71%
	TAFO CERAMIC	Tregtare	3555595	3327986	1,23%	1,20%	93,60%
	MAKSIT	Tregtare	9792464	9162433	3,37%	3,29%	93,57%
	EURO BETON MIX	Prodhuese	47190137	45583685	16,26%	16,39%	96,60%
	BETON GROUP	Prodhuese	77273674	76377239	26,62%	27,46%	98,84%
	NEDO KOMPANI	Tregtare	24949488	22405757	8,60%	8,06%	89,80%
	<b>Mesatarja e grupit III</b>			<b>15275265</b>	<b>14638796</b>		

Përpunuar nga autori në bazë të dhënave të: Zyra për Financa dhe kontabilitet " Dinor Consalting " Tetovë



Në tabelën nr. 12 të dhënat e paraqitura në grupin e parë **(I)** të ndërmarrjeve rezultojnë në një mesatare të të hyrave prej 59,259,664 nga gjithsej numri i ndërmarrjeve tre (3) prej tyre e përbëjnë mesataren e të hyrave me 67,06% në përpjestim me totalin e të hyrave si mesatare të përgjithshme. Ky proporcion vjen si rezultat i numrit të punëtorve të këtyre tre ndërmarrjeve të cilat kanë mesatarisht 33 të punësuar, ndërsa mesatarja e tërë grupit është 19 punëtor.

Pjesa tjetër e këtij grupi përfshijnë 32,94% të të hyrave në përpjestim me totalin e të hyrave me mesataren e përgjithshme.

Mesatarja e shpenzimeve të përgjithshme në këtë grup është 54. 879. 278 dhe gjithashtu ndërmarrjet që përbëjnë pjesën më të madhë të të hyrave, kanë edhe më tepër shpenzime, pra 66. 04% që është e njëjtë si përqindje tek shpenzimet si edhe tek të hyrat.

Nga të hyrat e mesatares së ndërmarrjeve në grupin e parë tek 80 % e ndërmarrjeve shpenzimet si përqindje e totalit të të hyrave në përgjithsi arrijnë 90,03%.

Veçohet ndërmarrja NPK SHARRI ku të hyrat tejkalojnë 24% të shpenzimeve që është në favor pozitiv në krahasim me ndërmarrjet tjera të grupit.

Në tabelën nr. 12 të dhënat e paraqitura në grupin e dytë **(II)** të ndërmarrjeve rezultojnë me mesatare të të hyrave 2,177,046. Me numër të punëtorëve të njëjtë me mesataren e këtij grupi të ndërmarrjeve dominojnë tre (3) ndërmarrje që kanë paraqitur 66. 26% të të hyrave mesatare nga totali i të hyrave, ndërsa 33. 74% të të hyrave mesatare e përbëjnë shtatë (7) ndërmarrjet tjera që në përgjithësi tregojnë disbalancë të hyrave të këtij grupi edhe pse me numër mesatar të njëjtë të punëtorëve.

Mesatarja e shpenzimeve të përgjithshme në këtë grup është 20,106,770 dhe vërehet që gjithashtu ndërmarrjet që përbëjnë pjesën më të madhe me të hyra mesatare, kanë edhe më tepër shpenzime, pra 67. 16% që është një proporcionale si përqindje tek shpenzimet si edhe tek të hyrat. Ndërmarrjet tjera të këtij grupi që janë 70% kapin 32. 84% nga shpenzimet totale dhe janë të përafërta ndërmjet veti.

Nga të hyrat e mesatares së ndërmarrjeve në grupin e parë tek 50 % e ndërmarrjeve shpenzimet si përqindje e totalit të të hyrave në përgjithsi arrijnë 98% që nuk duket si reale, pra kanë punuar për 5 vite pa fitim. Tek 40% të ndërmarrjeve shpenzimet kapin vlerën prej 91. 48% të të hyrave totale mesatare të grupit dhe pjesa tjetër e ndërmarrjeve që është 10% apo një (1) kemi shpenzimet mesatare që janë 58. 16% e të hyrave të përgjithshme mesatare që paraqet fenomen të rrallë të ndërmarrjeve të analizuar në këtë punim por edhe tek ndërmarrjet në rajon.

Në tabelën nr. 12 të dhënat e paraqitura në grupin e ndërmarrjeve mikro **(III)** që janë në numër 19, tregojnë mesatare të të hyrave prej 15,275,265. Me numër të njëjtë të punëtorëve me mesataren e grupit që është afër 3 punëtor, tek ky grup dominojnë katër (4) ndërmarrje që paraqesin 21% nga numri i ndërmarrjeve nga ky grup, kanë paraqitur 60. 50% të të hyrave mesatare nga totali i të hyrave. Pjesa tjetër prej 79% e ndërmarrjeve kanë paraqitur të hyra 39. 5% të të hyrave të shumës së përgjithshme që do të thotë 2. 63% si mesatare e të hyrave të tyre dhe tregojnë luhajtje të vogla ndërmjet të hyrave të këtij grupi edhe pse me numër mesatar të njëjtë të punëtorëve.

Mesatarja e shpenzimeve të përgjithshme në këtë grup është 14,638,796 dhe vërehet që gjithashtu ndërmarrjet që përbëjnë pjesën më të madhë me të hyra mesatare, kanë edhe më tepër shpenzime, pra 58. 8% që është e proporcionale si përqindje tek shpenzimet si edhe tek të hyrat. Ndërmarrjet tjera të këtij grupi janë 32. 84% nga shpenzimet totale.

Nga analiza e mesatares së të hyrave dhe shpenzimeve në tabelën numër 12 vërehet se tek ndërmarrjet e vogla dhe mikro raporti i të hyrave dhe shpenzimeve është përafërsisht konstant i njëjtë dhe ka ngjashmëri të madhe.

Në ndërmarrjet mikro shpenzimet totale në raport me të hyrat janë në përgjithsi 93. 5%. Tek 10. 5% të ndërmarrjeve shpenzimet tejkalojnë të hyrat për 15. 67%. të të hyrave totale mesatare të grupit. Pjesa e dytë e ndërmarrjeve që është shtatë (7) paraqesin shpenzime mesatare që janë 84% e të hyrave të përgjithshme mesatare dhe janë në gjendje shumë të favorshme dhe pjesa e tretë nga ndërmarrjet mikro të analizuara kanë shpenzime mesatare 95. 76% e të hyrave të përgjithshme mesatare.

## **5. Ndikimi i Covid-19 në performancën e ndërmarrjeve të analizuara dhe krahasimi i rezultateve me vitin 2019**

Në fillim të vitit 2020, më saktësisht në fillim të muajit Mars, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli gjendje pandemie për shkak të Korona virusit. Në mënyrë të njëjtë veproi edhe qeveria e RMV me shpalljen e masave për mbrojtje nga Koronavirusi.

Me datë 25.03.2020 miratoi me Dekret me fuqi ligjore lehtësime për ndërmarrjet me të drejtë për ulje të shumës së pagesës paraprake të tatimit për të ardhura personale propozohet që të kenë tatimpaguesit të cilët realizojnë të ardhura nga veprimtaria e pavarur dhe kryejnë veprimtari të përcaktuar në bazë të Klasifikimit nacional të veprimtarive - KNV Rev.2: veprimtari të hotelarisë (shifra 56- veprimtari për përgatitje dhe shërbime të ushqimit), turizëm (shifra 79 – Agjenci turistike organizatorë të udhëtimeve (turoperator) dhe shërbimet e tjera të rezervimit, si dhe aktivitete në lidhje me atë dhe shifra 55- Objekte të akomodimit) dhe transport (shifra 49 Transporti tokësor dhe transporti i tubacionit, shifra 50 – Transporti ujor dhe shifra 51- Transport ajror) dhe ata të cilët i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Mos të paguaj dividendë pronarëve, shpërblime për sukses afarist (pjesëmarrjen në fitim, shpërblim) ose lloj tjetër të shpërblimit vjetor për punonjësit dhe organeve të administratës dhe mbikëqyrje të tatimpaguesit, nga data e hyrjes në fuqi të këtij dekreti me fuqi ligjore deri në ditën e zgjatjes së lirimit.
- Tatimpaguesi- punëdhënësi të mos e ulë numrin e të punësuarave, duke e llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Dekreti me fuqi ligjore, tre muaj pas përfundimit të vlefshmërisë së saj, vetëm në rast të vdekjes, të pensionimit ose dhënie të dorëheqjes nga i punësuari. Gjithashtu propozohet e drejta e uljes së shumës së pagesës paraprake të tatimit të të ardhurave personale të vlejë edhe për tatimpaguesit tjerë të cilët kanë pësuar humbje në punën e tyre, të cilët përveç kushtit të lartpërmendur, plotësojnë një nga kushtet vijuese:
- Të ardhurat e përgjithshme të tatimpaguesit janë zvogëluar për së paku 40% në muajin aktual në krahasim me muajin shkurt 2020, ose ulja e të ardhurave totale në vitin 2020 është më shumë se 40% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ose
- Numri i punonjësve që nuk punojnë gjegjësisht nuk kontribuojnë në veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit – punëdhënësi, me qëllim të zbatimit të masave nga paragrafi (1) të këtij neni të jetë të paktën 25% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në raport me muajin shkurt 2020, ose
- Tatimpaguesi ka mbyllur të paktën 50% pikave të shitjes përmes të cilave bën qarkullim (filialet, objektet shitëse).

Qeveria gjithashtu miratoi Dekretin me fuqi ligjore për aplikimin e Ligjit për tatim të fitimit gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, me të cilin si masë për mbështetje të kompanive të cilave u është shkaktuar dëm në punën e tyre për shkak të përhapjes së virusit Korona, COVID-19 do të jenë të liruar nga pagesa e pagesës paraprake të tatimit të fitimit për muajin Mars, Prill dhe Maj 2020.

Në mbledhjen e 28-të, Qeveria miratoi Dekretin me fuqi ligjore për mënyrën e ndryshimit të kushteve të marrëveshjeve të ekspozimit të kredisë ndaj bankave dhe shtëpive të kursimit.

Me të vërtetohet si në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme të hapen mundësit e dhëna me ndryshimet rregullatorë të miratuara nga Banka Popullore të orientuara drejt lehtësimit të ngarkesës financiare të qytetarëve dhe të firmave të cilët për shkak të krizës së koronës ballafaqohen ose do të mund të ballafaqohen me vështirësi reale në shlyerjen e kredive në bankat dhe shtëpitë e kursimit. Dekreti është punuar nga Banka Popullore, Ministria e Financave dhe Asociacioni i Bankave të Maqedonisë.

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Qeveria sot miratoi Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për shoqatat tregtare gjatë gjendjes së jashtëzakonshme:

Me nenin 1 të Dekretit rregullohet zbatimi i Ligjit për shoqata tregtare gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, me çka është rregulluara që për thirrjen dhe mbajtjen e kuvendit vjetor të aksionarëve dhe mbledhjes së partnerëve, nga organi administrues i shoqërive aksionare, gjegjësisht organi drejtues i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar do të zbatohen dispozitat e këtij Dekreti me fuqi ligjore.

Në këtë drejtim, me nenin 2 të Dekretit mundësohet zgjatja e afateve për thirrjen dhe mbajtjen e kuvendit vjetor të aksionarëve, si dhe mbledhjen e partnerëve, nga ana e shoqërive tregtare, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme. Zgjatja e afateve gjithashtu i referohet procedurave të filluara për thirrjen dhe mbajtjen e një kuvendi vjetore të aksionarëve, d.m.th. një mbledhje të partnerëve.

Parashihet që kjo zgjidhje ligjore të sigurojë kushte të favorshme për shoqatat tregtare në lidhje me detyrimin për të mbledhur dhe organizuar kuvende vjetore të aksionarëve, gjegjësisht mbledhje të bashkëpunëtorëve, brenda së cilës miratohen llogari vjetore dhe raporte financiare, si dhe miratohet puna e anëtarëve të organit udhëheqës së shoqërisë.

(<https://vlada.mk/node/20746?ln=sq>)

Me datë 6 Prill 2020 në Gazetën Zyrtare të RMV numër 92 Qeveria shpall Dekretin për subvencionimin e Kontributeve, neto rrogës për ndërmarrjet dhe Tregtarët individual për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2020.

Kushtet për Aplikim për këto lloj subvencione janë:

Subvencionimi i pagesës së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore nuk mund të përdoret për një person me punë me kohë të pjesshme shtesë me një punëdhënës tjetër, në përputhje me nenin 121 të Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Punëdhënësi, për secilin të siguruar, për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2020, subvencionohet shumën për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme në shumën 50% të llogaritur.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme nga tatimpaguesi, por jo më shumë se 50% e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme të llogaritura në pagën mesatare bruto për punonjës në Republikën e Maqedonisë Veriore, sipas të dhënave të Zyrës Shtetërore të Statistikave të botuara për janar 2020.

### **5.1. Kushtet për marrjen e subvencioneve.**

Për të përdorur subvencionin për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, punëdhënësi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Ulja e të ardhurave totale në Prill 2020, në Maj 2020 ose në Qershor 2020, të jetë më shumë se 30% në lidhje me të ardhurat totale mesatare në baza mujore të realizuara në 2019, dhe për një punëdhënës i cili është regjistruar në regjistrin përkatës (i vendosur) pas Marsit

2019, të ardhurat totale për Prill 2020, muaj Maj 2020 dhe qershor 2020 të ulen me të paktën 30% në lidhje me të ardhurat totale mesatare në baza mujore të realizuara nga dita e regjistrimit në regjistrin përkatës në 2019 dhe muajt janar dhe shkurt 2020. Për punëdhënësin që kryen veprimtari me karakter sezonal, zvogëlimi i të ardhurave mesatare për periudhën e fundit sezonale prej katër muajsh në krahasim me të ardhurat mesatare për periudhën sezonale të të njëjtit katër muaj në vitin paraardhës të jetë më shumë se 30%;

b) Numri i punonjësve me punëdhënësin që kërkon mbështetje financiare, duke marrë parasysh punonjësit përmes një agjencie private punësimi, nuk zvogëlohet për Prillin, Majin dhe Qershorin e vitit 2020 krahasuar me numrin e të punësuarve më 31 Mars, 2020 , përveç në rast pensioni ose vdekjeje dhe

c) Të mos paguajnë dividendë për pronarët, si dhe të mos kenë kryer një pagesë në bazë të një shpërblimi të performancës së biznesit (ndarja e fitimit, shpërblimi) ose një lloj tjetër shpërblimi vjetor për punonjësit dhe organet e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punëdhënësit, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij dekreti, deri në ditën e dorëzimit të llogarive vjetore/raporteve financiare për vitin 2020.

Subvencionimi i shumës për pagimin e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror në përputhje me këtë rregullore me fuqi ligjore, nuk mund të arrihet nëse punëdhënësi përdor mbështetje financiare për pagën e pagës neto në vlerë deri në 14,500 denarë në muaj për çdo punonjës për muajt prill dhe maj 2020 sipas Dekreti me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të punëdhënësve nga sektori privat i prekur nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga virusi COVID-19, për shkak të pagesës së pagave për muajt prill dhe maj 2020.

Subvencionimi i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme në përputhje me këtë Dekret me forcë ligjore nuk mund të përdoret njëkohësisht për një punonjës për të cilin punëdhënësi përdor subvencione sipas Ligjit për Subvencionimin e Kontributeve të Sigurimeve të Detyrueshme Shoqërore për shkak të rritjes së pagave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore Nr. 239/19).

Për të ushtruar të drejtën nga kjo rregullore me fuqi ligjore, punëdhënësi paraqet një kërkesë për subvencionimin e shumës për pagimin e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore në Zyrën e të Ardhurave Publike.

Në Kërkesë, punëdhënësi bashkangjet një Deklaratë nga përfaqësuesi ligjor për përmbushjen e kushteve të kësaj rregulloreje me fuqi ligjore. Dorëzimi i Kërkesës bëhet përmes sistemit të E-taksave të Zyrës së të Ardhurave Publike, dhe kërkesa e plotë konfirmohet nga Zyra e të Ardhurave Publike, brenda pesë ditëve nga dita e paraqitjes së saj.

Tatimpaguesi në llogaritjen Mujore për mbledhjen e integruar (formulari MPIN), të cilën ai e paraqet në Zyrën e të Ardhurave Publike, për të siguruarin për të cilin kërkon subvencionimin e pagesës së kontributeve në fushën 3.23, shkruhet kodi 620.

Zyra e të Ardhurave Publike, për personat e siguruar për të cilët është aprovuar një subvencion, zvogëlon shumën e detyrimit për të paguar kontributet e sigurimeve të detyrueshme shoqërore për shumën e subvencionit të miratuar të kontributeve.

Të dhënat për subvencionin e aprovuar për pagimin e kontributeve dorëzohen nga Zyra e të

Ardhurave Publike në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, jo më vonë se 20 të muajit për muajin paraardhës.

Shuma e subvencioneve të miratuara të kontributeve në muajin e mëparshëm paguhet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në llogari speciale për kontributet e sigurimeve të detyrueshme shoqërore, jo më vonë se 10 ditë pas marrjes së të dhënave nga Zyra e të Ardhurave Publike.

Punëdhënësi që ka përdorur subvencionin për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme është i detyruar të kthejë mjetet e marra financiare në tërësi, nëse pas një kontrolli nga Zyra e të Ardhurave Publike dhe / ose Inspektorati Shtetëror i Punës, përcaktohet se punëdhënësi nuk i ka përmbushur kushtet. nga ky dekret me fuqi ligjore, bazuar në një vendim për parregullsi të vërtetuar.

Punëdhënësi i cili ka përdorur të drejtën nga ky dekret me fuqi ligjore, dhe nuk i ka përmbushur kushtet nga ky dekret me fuqi juridike, është i detyruar të kthejë shumën e subvencioneve për pagimin e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, në kurriz të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë Veriore.

Punëdhënësi i cili ka përdorur të drejtën e subvencionimit për pagimin e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, është i detyruar të kthejë fondet e marra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë Veriore, por jo më shumë se shuma prej 50% e:

- Rezultati i arritur financiar për vitin 2020 u rrit me shumën e shpenzimeve të tatueshme dhe më pak të ardhurat e deklaruar nga Bilanci Tatimor;
- Rezultati i arritur financiar nga Pasqyra e të Ardhurave (fitimi para tatimit) për vitin 2020 për obligacione që janë në regjimin vjetor të tatimit mbi të ardhurat;
- Shuma e rezultatit financiar të paraqitur para tatimit në formën B, e rritur për shpenzimet e panjohura për qëllime tatimore nga bilanci vjetor tatimor për përcaktimin e tatimit mbi fitimin nga kryerja e veprimtarisë së pavarur.

Rimbursimi do të bëhet në tre këste mujore pa interes në prill, maj dhe qershor 2021.

Më poshtë në tabelën nr. \_\_ paraqiten të dhënat për tre llojet e kompanive të analizuar në këtë punim për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar-Shtator 2020 në krahasim me Janar-Shtator 2019, analiza e trendit të të hyrave dhe shpenzimeve për këtë periudhë.

	FIRMAT	Të hyrat e pergjithshme 1-9/2019	Të hyrat e pergjithshme 1-9/2020	Shpenzimet e pergjithshme 1-9/2019	Shpenzimet e pergjithshme 1-9/2020	ANALIZA E TRENDIT TË TË HYRAVE 20/19	ANALIZA E TRENDIT TË SHPENZIMEVE 20/19
I	<b>NURO KOMERC</b>	94811387	98600128	64158126	86283748	4%	34%
	<b>SEDRA DOO</b>	5769553	5011861	4824606	4670672	-13%	-3%
	<b>BESA SHOP</b>	17838907	14101723	4749843	8645504	-21%	82%
	<b>EUSS SECURITY</b>	4004434	2168582	2777041	2606213	-46%	-6%
II	<b>REGALL KOMERC</b>	3317255	3257861	4311287	2877483	-2%	-33%
	<b>SWISS CENTAR</b>	23340230	13911863	17331125	10923879	-40%	-37%
	<b>NASER KOMPANI</b>	1066855	1390534	1703195	1026043	30%	-40%
	<b>MUJO KOMPANI</b>	1648256	1153288	1249293	1722067	-30%	38%
	<b>JEKA IDEAL</b>	20707091	14499354	12658773	10757958	-30%	-15%
	<b>FLOOR</b>	4000293	831962	3466378	1083218	-79%	-69%
III	<b>VENECIA MUNISHI</b>	5950386	4495791	5108795	3935734	-24%	-23%
	<b>DINOR CONSALTING</b>	2225156	2079276	676547	1225427	-7%	81%
	<b>AGRO REKA</b>	7265979	3607452	5910063	2084562	-50%	-65%
	<b>DANI MB</b>	3826657	2515676	3118434	2233025	-34%	-28%
	<b>INTER TOPING</b>	6672771	3117890	1271051	2477474	-53%	95%
	<b>UNIMETAL</b>	12608888	13248222	5115785	8189977	5%	60%
	<b>XHIHAN KOMPANI</b>	2891099	5331343	3195462	2906713	84%	-9%
	<b>SEMPERIT EZ</b>	1665289	1096464	2430965	1290888	-34%	-47%
	<b>TAFO CERAMIC</b>	3966238	4384131	3418460	3801979	11%	11%
	<b>MAKSIT</b>	1163881	1326984	1438884	1275444	14%	-11%
	<b>EURO BETON MIX</b>	21951988	62894997	19999277	4646129	187%	-77%
	<b>BETON GROUP</b>	6410007	1065678	4843427	228309	-83%	-95%
<b>NEDO KOMPANI</b>	64256488	39927067	36875825	24878379	-38%	-33%	

Tabela nr.13

Nga tabela e analizuar e të dhënave mund të shohim se:

- Shumica e ndërmarrjeve kanë zvogëlim të të hyrave dhe zvogëlim të shpenzimeve dhe kjo ndodh te 12 nga 23 ndërmarrjet e analizuar apo afër 52%.
- Tek 3 nga 23 ndërmarrjet apo 13% kanë trend pozitiv ose rritje të të hyrave dhe shpenzimeve
- Pjesa e ngelur, 35% kanë luhatje dhe joproportionalitet të shpenzimeve me të hyrat për periudhën e krahasuar.

Në grupin e 12 ndërmarrjeve që kanë rezultuar me rritje të shpenzimeve dhe rrënie të të hyrave shihet qartë ndikimi nga pandemia globale. Ndërmarrjet e analizuar kanë rrënie të ndryshme të të hyrave me një mesatare prej 39.42%, ndërsa shpenzimet janë zvogëluar mesatarisht 37.83%.

Edhe pse duket se niveli i të hyrave dhe shpenzimeve të ndërmarrjeve është koherent, në këtë rast te të hyrat janë përfshirë edhe të hyrat nga subvencionet shtetërore për 3 muaj.

Nëse i zvogëlojmë të hyrat nga subvencionet për të gjitha 12 ndërmarrjet e analizuar atëherë do të shohim se të hyrat mesatare zvogëlohen edhe 2% më tepër pra në total 41.42%. Duhet theksuar se te të dhënat e paraqitura kemi edhe 2 veprime që kanë ndikuar në këto rezultate financiare:

1. Disa ndërmarrje që kanë fituar të drejtën për subvencione të pagave dhe kontributeve, nuk e kanë shfrytëzuar për shkak të kushtit që kërkon kthim të këtyre mjeteve në vitin e ardhshëm në një përqindje në bazë të vlerës së tatimit në fitim.

2. Ndërmarrjet tjera që kanë arritur kushtin për të fituar subvencione shtetërore, në bankë e

kanë deponuar si hua apo mbulim të humbjes nga rezervat paraprake të akumuluar dhe shkaqe tjera objektive.

Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve që përfshin 3 ndërmarrje paraqet trend pozitiv, pra të hyrat dhe shpenzimet shënojnë rritje. Rritje proporcionale me 11% të të dy parametrat financiar paraqiten tek njëra ndërmarrje që tregon stabilitet financiar afatshkurtër të kësaj ndërmarrje.

Ndërmarrjet tjera paraqiten me performancë divergjente pasi që të hyrat kanë rritje minimale 4% gjegjësisht 5% ndërsa shpenzimet kanë rritje 34% dhe 60%. Te këto parametra financiarë, më shumë të shpenzimet ndikojnë disa faktorë siç janë investimet, maturimi dhe fshirja e kërkesave nga blerësit, mbulimi u humbjes, rritja e numrit të punëtorëve, rritja e pagës minimale në shtet, shlyerja e detyrimeve nga vitet paraprake etj.

Lloji i tretë i ndërmarrjeve të analizuara, përfshin ndërmarrjet që tregojnë rezultate financiare të pazakonshme në përgjithësi me joproportionalitet të madh.

Te njëra pjesë e ndërmarrjeve kemi rënie të tredit të të hyrave mesatarisht 28% dhe rritje të trendit të shpenzimeve mesatarisht 74%.

Pjesa tjetër ka performancë të kundërt me të parën edhe atë mesatarisht rritje të trendit të të hyrave me 79% ndërsa trendi i shpenzimeve ka zvogëlim mesatar prej 34%.

	FIRMAT	Nr.punt 2019	Nr.punt 2020	Mesatarja puntoreve 2020/2019	Subvencione 4/2020	Subvencione 5/2020	Subvencione 6/2020
I	<b>NURO KOMERC</b>	33	33	0%	0	0	0
	<b>SEDRA DOO</b>	13	15	15%	164773	(145000+39845) =184845	(181250+39646) =220896
	<b>BESA SHOP</b>	11	14	27%	145000	(174000+38225) =212225	0
	<b>EUSS SECURITY</b>	11	17	55%	175500	157500	143000
II	<b>REGALL KOMERC</b>	9	9	0%	116000	116000	0
	<b>SWISS CENTAR</b>	8	6	-25%	0	0	0
	<b>NASER KOMPANI</b>	4	6	50%	0	0	0
	<b>MUJO KOMPANI</b>	6	6	0%	50750	50750	50750
	<b>JEKA IDEAL</b>	7	9	29%	87000	0	0
	<b>FLOOR</b>	7	6	-14%	0	0	(58000+15325) =73325
III	<b>VENECIA MUNISHI</b>	4	4	0%	0	0	0
	<b>DINOR CONSALTING</b>	4	4	0%	0	0	0
	<b>AGRO REKA</b>	1	3	200%	0	0	0
	<b>DANI MB</b>	3	3	0%	43500	43500	43500
	<b>INTER TOPING</b>	3	3	0%	0	0	0
	<b>UNIMETAL</b>	4	4	0%	0	0	0
	<b>XHIHAN KOMPANI</b>	3	3	0%	0	0	0
	<b>SEMPERIT EZ</b>	3	1	-67%	29000	29000	29000
	<b>TAFO CERAMIC</b>	2	2	0%	0	0	0
	<b>MAKSIT</b>	2	2	0%	0	29000	29000
	<b>EURO BETON MIX</b>	2	2	0%	0	0	0
	<b>BETON GROUP</b>	2	1	-50%	0	0	0
	<b>NEDO KOMPANI</b>	1	1	0%	14500	14500	0

Tabela nr.14 paraqet trendin e numrit të punëtorëve për vitet 2020 në krahasim me vitin 2019 që dhe shfrytëzimin e subvencioneve.

Nga kjo tabelë shohim se sa i përket numrit të punëtorëve vërehet se vetëm 4 ndërmarrje kanë zvogëluar numrin e punëtorëve edhe atë nga gjithsej 20 veta në vitin 2019 në 16 të punësuar në vitin 2020.

Rritje të numrin të të punësuarve kanë 6 ndërmarrje me mesatare të përgjithshme prej 62.66% apo nga 47 të punësuar në 64 të punësuar. Pjesa tjetër apo 13 ndërmarrje kanë numër të njejtë të punëtorëve për periudhën e analizuar.

Marrë në përgjithësi tek 23 ndërmarrjet për periudhën e analizuar në vitin 2019 kishin 143 të punësuar ndërsa në vitin 2020 kanë 154 të punësuar që është rritje prej 7.69%.

Sa i përket shfrytëzimit të subvencioneve 12 nga 23 ndërmarrjet e analizuara nuk kanë

shfrytëzuar aspak subvencione shtetërore për kontribute dhe neto rroga sepse kanë patë rritje të të hyrave, zvogëlim të numrit të punëtorëve apo shkaqe tjera të lartëpërmendura.

Vetëm 5 apo 21.74% nga ndërmarrjet e analizuar kanë shfrytëzuar subvencionet për 3 muaj komplet.

Të hyrat e përgjithshme nga subvencionet për 3 muajt që ndërmarrjet kanë fituar kap vlerën e 2.059.064 ndërsa të hyrat e këtyre ndërmarrjeve që kanë fituar subvencionet është 85.890.822 që tregon se të hyrat nga këto subvencionë janë 2.39% të të hyrave të përgjithshme. Kjo tregon se subvencionet në përgjithësi shumë pak ndikuar në përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve të analizuar apo në këtë rast nuk kanë arritur efektin e dëshiruar.

## 5.2. Konkluzione dhe Rekomandime

### 5.3. Konkluzionet

Sipas nomenklaturës në RMV për kategorinë e subjekteve e rajonin e Tetovës mund të shihet se 75,77% tu subjekteve janë mikro subjekte dhe 22,91 % subjekte të vogla që tregon se në këtë rajon dominojnë veprimtaritë tregti dhe shërbime. Subjektet që u analizuan në këtë temë masteri janë: Subjektet prodhuese, subjektet tregtare dhe subjektet shërbyese.

Nga analizat e kryera te 39 subjekte ekonomike nga te cilat janë: 10 kompani të mesme, 10 të vogla dhe 19 mikro kemi ardhur ne gjetje te besueshme te cilat ne mase te konsiderusheme verifikojn hipotezat e parashtruara dhe janë kompatible me objektivat e përcaktuara.

#### Treguesit kryesor cilesor te perfomancës ekonomike-financiare të kompanive të analizuar

KATEGORIA E SUBJEKTEVE	Të hyrat e përgjithshme (2015-2019)	Shpenzimet e përgjithshme (2015-2019)	Nr i të punësuarve (2015-2019)	Rroga neto për punëtor(2015-2019)	Fitimi për punëtor (2015-2019)	Fitimi neto(2015-2019)	Tatimi në Fitim(2015-2019)
TË MESME	12.04%	9.91%	3.69%	9.17%	18.16%	6.52%	6.52%
TË VOGLA	2.97%	3.78%	1.06%	3.59%	-54.54%	-4.42%	-4.42%
MIKRO	0.83%	0.23%	0.10%	1.16%	37.66%	3.45%	-4.17%

Në tabelën e mësipëme janë paraqitur treguesit kryesor me të cilat është matur performanca ekonomike dhe financiare e subjekteve ekonomike me performacë mikro , të vogël dhe të mesme në bazë të analizës së trendit gjatë periudhës së analizua (2015-2019 ).

**H1- Në kompanitë e mesme të veprimtarive prodhuese dhe shërbyese në rajonin e Tetovës ka korelacion pozitiv në mes të trendit të të hyrave, shpenzimeve dhe fitimit në periudhen e analizuar.**


Nga gjetjet e analizave të bëra mund të konstatojm se gjatë periudhës së analizuar (2015-2019) pranohet **Hipoteza 1** që e ka kuptimin se ka korelacion pozitiv në trendin rritës te ndërmarrjet e mesme në kategorin e të hyrave të përgjithshme për 12,04% ,shpenzimet e përgjithshme për 9,91% dhe fitimi neto për 6,52%. Trendet pozitive në fjalë në një ambient ekonomik social turbulent në RMV janë pasqyrë e strukturës se kapitalit, burimeve njerëzore, potencialit financiar, pozicionit në treg dhe menaxhmentit fleksibël të kompanive të analizuar.

Marë në përgjithsi, ndërmarrjet e analizuar që janë objekt i këtij punimi kanë rritje graduale të të hyrave vit për viti nga 2015 deri 2019.



**H2- Në kompanitë mikro dhe të vogla në rajonin e Tetovës si rezultat i trendit rritës më të lartë të shpenzimeve mbi të hyrat ka efektuar ulje të performancës ekonomike dhe financiare në periudhën e analizuar.**

Trendi i te hyrave te pergjitheshme, shpenzimeve dhe fitimit neto ( 2015-2019)




Nga raportet e përlogaritura të analizës së trendit të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla për periudhën kohore 2015-2019 mund të konstatojmë se Hipoteza H2 pranohet sepse është në harmoni me përmbajtjen e kësaj Hipoteze. Këtë e vërteton vetë fakti që trendi i shpenzimeve ka përqindje më të lartë të rritjes (3,78%) në raport me trendin e të hyrave (2,97%).

Për pasojë të këtij trendi dhe ndikimit të bilancit tatimor te keto kompani kemi ulje të neto fitimit për 4,42% në periudhën e analizuar. Faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar në këtë trend negativ sipas autorit të këtij hulumtimi janë:

- Gjendja jostabile ekonomike dhe politike në vend në këtë periudhë,
- Rritja e ekonomisë informale dhe krijimi i distorzit të lart në tregun ekonomik,
- Rritja e pagës minimale neto për kompanitë që ka efektuar kosto shtese për kompanin pa ofertë të kompensimit në aspekt fiskal dhe social, kjo tendencë rritje vjen si pasojë e ndryshimeve ligjore dhe politikave pozitive të ndërmarra nga organet shtetërore. Pra, rritja nuk lidhet direkt me politikën e kompanive të analizuar dhe mund të konkludojmë se kompanitë në fjalë nuk kanë politikë dhe hierarki të qartë për avansim dhe ngritje sipas përvojës, shkathtësive dhe profesionalizimit të punëtorve.
- Qasja agresive dhe politikën ndëshkimit nga ana e DAP për kompanitë ku janë paraqitur këto dukuri që është karakteristike edhe për kompanitë e analizuar.

**H3- Performanca ekonomike dhe financiare e kompanive të analizuar (mikro dhe të vogla) duhet të mirëtohet me rezervë sepse shumica e kompanive krahas aktivitetit formal ushtrojnë paralelisht edhe aktivitet informel që nuk pasqyrohet si pjesë integrale e pasqyrave financiare.**

Trendi i te hyrave te pergjitheshme, shpenzimeve dhe fitimit neto ( 2015-2019)



Nga Hipotezat e parashtruara në këtë punim dhe nga gjetjet e mostrës së ndërmarrjeve të analizuar në rajonin e Tetovës, Hipoteza H3 është më përfaqësuesja. Kjo Hipotezë është përgjithësisht e njohur dhe pranuar pasi që nga analizat financiare të këtyre ndërmarrjeve arrijmë edhe me fakte që vërtetojnë pranueshmërinë e kësaj Hipoteze.

Nga analizat e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla vërejmë se të tre indikatorët kanë raport 1:1:1 që do me thënë se kurba e këtyre indikatorëve lëviz në mënyrë paralele pothuajse të dirigjuar. Shënimin e lartpërmendur e vërteton fakti se nga analiza e këtyre ndërmarrjeve, gjemë se trendi i përgjithshëm i ndërmarjeve të vogla dhe mikro i të hyrave është 1.9%, shpenzimet 2% dhe fitimi neto -0.5%.

Këto tregues financiarë argumentojnë me së miri se performanca ekonomike dhe financiare e kompanive të analizuar (mikro dhe të vogla) duhet të miret me rezervë sepse shumica e kompanive krahas aktivitetit formal ushtrojnë paralelisht edhe aktivitet informel që nuk është pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Ndikimet negative nga pasojat e Covid-19 janë prezente edhe te kompanit e rajonit të analizuar - Tetovës. Këto pasoja kanë efektuar që një pjesë e konsiderueshme e kompanive edhe pse kanë pasur ramje të thëksuar të të hyrave të përgjithshme nuk kanë aritur të marrin subvencionet fiskale nga shteti sepse nuk kanë plotësuar kriteriumet e përcaktuara nga DAP. Vetëm 1/3 e kompanive të analizuar kanë arritur të marrin subvencionet në fjalë dhe të zbusin pasojat negative nga ramja e aktivitetit të përgjithshëm. Analizat financiare që do të bëhen pas përfundimit të vitit afarist 2020 do të nxjerrin në sipërfaqe trende shumë më negative në pjesën e të hyrave dhe të fitimit si pasojë e COVID-19 në krahasim me trendin e periudhës 2019-2015.

#### **5.4. Rekomandimet**

Subjektet ekonomike në rajonin e Tetovës përgjatë viteve të analizuar (2015-2019) kanë treguar gjendje ekonomike financiare në një nivel mesatar. Nga përvoja ime si kontabiliste mund të vijë në përfundim se shumica e subjekteve ekonomike tentojnë të pasqyrojnë rezultate financiare vjetore më të ulëta me qëllim të zvoglimit të të gjitha tatimeve dhe në mënyrë të veçantë të tatimit në fitim. Si rezultat i këtij veprimi ata cenojnë mundësinë e realizimit të rezultatit financiar pozitiv dhe të bashkepunimit potencial me kompani dhe institucione në vend dhe në botën e jashtme. Gjetjet e punimit dhe verifikimi i hipotezave nxjerr në sipërfaqe disa rekomandime potenciale:

- Subjektet ekonomike duhet të formalizojnë aktivitetin ekonomik në kuptim të nënshkrimit të kontratave afariste me objektiv të paguajnë në kohe detyrimet dhe të arketojnë kërkesat dhe njëkohësisht të kenë bazë juridike për konstatime ligjore nëpërmjet përmbartësve dhe gjykatave ndaj partnerëve jokorekt në raportet afariste ,
- Subjektet ekonomike duhet të menaxhojnë me parimet e efektivitetit dhe efikasitetit aktivitetin operativ, prodhues, tregtar dhe keto operacione t'i kenë në korelacion me shitjet, likuiditetin dhe solventitetin si elemente bazë të planeve ekonomike që garantojnë qëndrueshmëri afatmesme të bizneseve.
- Subjektet ekonomike duhet të eliminojnë gradualisht ekonomin informale nga aktiviteti i tyre duke deklaruar të dhëna financiare të besueshme në raportet financiare periodike dhe vjetore si parakusht për rritjen e vlerës së tregut të kompanive dhe plotësimin të kriterëve të bankave komerciale për asistencë kreditore në situata të jolikuiditetit konjunktural dhe problemeve me arkëimtimin e kërkesave kontestuese.
- Subjektet ekonomike të risin mundësinë për punësime dhe trajnime të punonjësve me marrëdhënie të rregullt pune dhe të eliminojnë angazhimet informale të forcës punëtore.

- Menaxhementet dhe pronarët e kompanive duhet të anagzhohen për rritjen e vlerës ekonomike të kompanive duke rritur fitimet vjetore në menyrë të vazhdueshme dhe duke përmbushur detyrimet tatimore ndaj DAP-IT.
- Institucionet përkatëse si Ministria e Financave – DAP si dhe Regjistri Qendror i RMV të organizojnë aktivitete permanente për të edukuar stafin e menaxhmentit të kompanive rreth rëndësisë së performancës ekonomike dhe financiare në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale dhe kombëtare.
- Kompanitë e rajonit të Tetovës duhet të jenë më aktive në ndërtimin e një bashkëpunimi permanente në mes të Odave ekonomike, Universiteve, qeverive lokale dhe qeverisë qendrore në funksion të promovimit të bashkëpunimit në mes të bizneseve lokale dhe institucioneve në fjalë në funksion të rritjes së aftësisë konkurruese të bizneseve dhe punësimit të kuadrit të ri universitar si vlerë shtesë në rritjen e performancës ekonomike dhe financiare në plan afatmesëm.
- Mungesa e burimeve njerëzore cilësore në këto kompani është mungesa kryesore e cila pamundëson stabilizimin dhe zhvillimin permanent në hap me trendet e integritit ekonomik rajonal dhe global.

## Referencat

- [1] H.Xhafa (2010). " Analiza e pasqyrave Financiare". Botimi 3, Tiranë
- [2] R.Osmani (2011).’’ Kontabiliteti Menaxherial për Biznes’’ .UEJL, Botimi 2, Tetove,
- [3] R.Osmani (2015). Improved Business Climate and FDI in the W.Balkans. JES Studies, Sarajevo,
- [4] R.Osmani & F.Morina. Institutional reforms and improving the business climate in Southeast European countries: an empirical analysis. In *7th ISC “Contemporary Economic Trends”* ,University of Tetova,Tetovë,
- [5] R.Osmani & V.Xhila. The changes in profit tax policies has had a negative impact on the economic performance of businesses in the region of Struga. In *2nd ISCBE’18) “Business Education in the 21st Century”* , Tetovë,
- [6] Rufi Osmani & Fitim Deari . Firms’ financial performances and economic recession: evidence from NM listed companies, . In *Bulletin of the Transylvania University of Braşov, Romania*
- [7] Ali,A. and L-S.Hëang. (2000) ‘‘Country-specific factors related to financial reporting and the value relevance of accounting data’’.*Journal of Accounting Research vol.38*, Blake, J., Akerfeldt,K., Fortes,H. and Gowthorpe,C., 1997 ‘‘The relationship between tax and accounting rules’’-The Sëedish Case’’,*European Business Economics, vol.97*, Burgsthaler, D., Elliott, W.B. and Hanlon,M.(2002), Hoë Firms Avoid Losses: Evidence of Use of the Deferred Tax Asset Account. *Working Paper*.
- [8] Beaver Graham, Jennings Peter (2000),‘‘Editorial overview: small business, entrepreneurship and enterprise development’’, Strategic Change, Vol. 9, Southampton, UK,
- [9] Risteska Aneta, (2013) Doktoratura disertacija, vlijanie na malite i srednite pretprijatija vz ekonomskiot razvoj, so poseben osvrt na RM, Prilep
- [10] R.Osmani , Kontabiliteti Financiar,Dispense e autorizuar,UEJL,2018
- [11] R.Osmani ,Analiza e pasqyrave financiare,ligjerata te autorizuar,dispensa Tetovë 2018
- [12] Xhafa Halit,Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë.
- [13] Matelievaska Margarita, Paceskoski Vlatko, (2011). Ekonomija na trgovski drushtva, Skopje.
- [14] Charles T. Horring, Gary -L. Sandem, John A. Eliot, Donna R. Filbrick, (2010) "Hyrje në Kontabilitetin Financiar", përkthimi i edicionit të nëntë, USA.
- [15] Nikolovski Pece, (2003). Analiza i revezija na finansiskite izveshtai na pretprijatijata vo RM vo funkcija na ekonomska efikasnost" – Doktorska Disertacija, Ekonomski Fakultet – Prilep.
- [16] Ivanis M., (2012) ‘‘Uvod u korporativne finansije i tehnike upravljanja korporativnim finansijama’’, Univerzitet Singidunum Beograd, Serbija
- [17] Sasho Arsov, (2008) "Finansiski Menaxhment", Skopje.
- [18] Stojilković Mladen, Krstić, J.,(2000), Finansijska analiza. Ekonomski fakultet, Nish, Serbi
- [19] Drejtoria e të ardhurave publike ne MV ( [www.ujp.gov.mk](http://www.ujp.gov.mk) )
- [20] Ministria e Financave ne R.M.V. ( [www.finance.gov.mk](http://www.finance.gov.mk) )
- [21] Instituti i Kontabilistëve dhe Kontabilistëve të Certifikuar (<https://isos.com.mk/>)
- [22] Gazeta Zyrtare e R.M ( [www.slvesnik.com.mk](http://www.slvesnik.com.mk)),
- [23] Rregullativa Ligjore ([www.pravo.org.mk](http://www.pravo.org.mk)),
- [24] [www.ec.europa.eu](http://www.ec.europa.eu)
- [25] [www.demonstratingvalue.org/resources/financial-ratio-analysis](http://www.demonstratingvalue.org/resources/financial-ratio-analysis)
- [26] <https://vlada.mk/node/20746?ln=sq>
- [27] Pasqyrat financiare të kompanive te cilat jan objekt studimi,
- [28] Publikime shkencore dhe profesionale te tjera.

## **Lista e tabelave**

- Tabela nr. 1 Kategoritë e subjekteve ekonomike në EU
- Tabela nr. 2 Kategoritë e subjekteve ekonomike në RMV.
- Tabela nr. 3 Raportet Financiare që dërgohen në regjistrin Qendror të Maqedonisë.
- Tabela nr. 4 Kategoritë e subjekteve ekonomike në Rajonin e Tetovës.
- Tabela nr. 5 Subjektet ekonomike në rajonin e Tetovës prodhuese, tregtare, shërbyese.
- Tabele nr. 6 Subjektet ekonomike në bazë të të hyrave.
- Tabela nr. 7 Subjektet ekonomike në bazë të shpenzimeve.
- Tabela nr. 8 Subjektet ekonomike në bazë të të punësuarve.
- Tabela nr. 9 Rroga neto për të punësuar.
- Tabela nr. 10 Subjektet ekonomike në bazë të Fitimit neto.
- Tabela nr. 11 Subjektet ekonomike në bazë të Tatimit në fitim.
- Tabela nr. 12 Subjektet ekonomike të treguesve financiar (mesatarja).
- Tabele nr.13 Analiza e trendit te subjekteve gjatë periudhës 2019-2020
- Tabela nr.14 Subjetet ekonomike të subvencionuara nga ana e Qeverisë.

## Lista e grafikoneve

Grafiku nr. 1	Klasifikimi i subjekteve ekonomike në RMV
Grafiku nr. 2	Mjedisi i analizës së raportit financiar
Grafiku nr. 3	Analiza e objektivave dhe raportimit financiar
Grafiku nr. 4	Të hyrat e përgjithshme në ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 5	Të hyrat e përgjithshme në ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 6	Të hyrat e përgjithshme në ndërmarrjet mikro
Grafiku nr. 7	Shpenzimet e përgjithshme në ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 8	Shpenzimet e përgjithshme në ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 9	Shpenzimet e përgjithshme në ndërmarrjet mikro
Grafiku nr. 10	Numri i të punsuarve në ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 11	Numri i të punsuarve në ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 12	Numri i të punsuarve në ndërmarrjet mikro
Grafiku nr. 13	Rroga neto në ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 14	Rroga neto në ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 15	Rroga neto në ndërmarrjet mikro
Grafiku nr. 16	Fitimi neto për ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 17	Fitimi neto për ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 18	Fitimi neto për ndërmarrjet mikro
Grafiku nr. 19	Tatimi në fitim për ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 20	Tatimi në fitim për ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 21	Tatimi në fitim për ndërmarrjet mikro
Grafiku nr. 22	Mesatarja në ndërmarrjet e mesme
Grafiku nr. 23	Mesatarja në ndërmarrjet e vogla
Grafiku nr. 24	Mesatarja në ndërmarrjet mikro